

BIBLIOTEKA E RINISË

# Ne jemi bashkë..

8SH-

N 36

VJERSHA, POEMA E  
TREGIME TË STUDENTËVE

SH-1

S

N 36

BIBLIOTEKA E RINISE

# Ne jemi bashkë...

(Vjersha, poema e tregime të studentëve)

~~48553~~  
13802

**BIBLIOTEKA E SHKOLËS  
DZONKURR**

SHKOLA DHE KULTURA PËR QËNDRËN NATIONALE TË SHTETIT

SHKOLA DHE KULTURA PËR QËNDRËN NATIONALE TË SHTETIT

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## PARTISË

Drejt majave të ndritura nga dielli rrezear  
ecën me hapa vigane sot Shqipëria,  
me Partinë në ballë marshon fitimtare,  
i kuq valon flamuri, e kuqe flakë liria.

E lavdishmja 25-vjeçarja Parti,  
le të buçasë për ty e madhërishme jehona!  
Përpara, drejt së ardhmes së lumtur na pri.  
Ti rrofsh fitimtare, rrofsh sa malet ton!

GJERGJ JUNÇAJ  
(Instituti Pedagogjik, Shkodër)

## P A R T I A

Partia!

Flamurtarja,  
fitorja jonë!

Partia  
kthen në shkrumb e hi  
maskat që fshehin tradhëtinë.

Parti!

Prej pesë germash shkruhesh në fjalë,  
po je kala,  
vargmal vigan.

Frymëzim,  
trimëri,  
dalin një goje  
me fjalën Parti.

HALIL BUÇPAPA

(Instituti Pedagogjik, Shkodër)

## PARTISË SIME

Për ty, Parti,  
këtu, mbi letrën time të bardhë,  
vargjet më të zjarra  
do të doja  
t'i shtroja.

I kam mbledhur këto vargje  
nga më të zjarrtat frymëzime  
dhe dua një ditë t'i këndojoj  
me titull: «Partisë sime».

Merrmë frymëzim, mua, studentin,  
në shpatet e Vaut të Dejës  
më dërgo!  
Të recitoj unë vargjet e mia  
në efektivin punonjës,  
hero.

Parti e Punës

revolucionare.

BURHAN NURÇE  
*(Instituti Pedagogjik, Shkodër)*

## POEZI MBI POEZI

(diametri)

Atdheu — një poezi;  
aksionet e rinisë  
në hapje taracash, në hekurudhë,

në Malësi  
— një poezi.

Lavdia e popullit — një poezi  
dy koka nën ombrellën blu,

e hapur në shi  
— më vete kjo poezi.

Tani dëgjoni:  
Partia — poezi mbi poezi.

ASTRIT NURI

## FLAMUJT VALVITEN

(Poemth)

### I

Parti! O nanë e bijve të mëdhaj.  
Parti! Farkëtuese miqshish t'pathyeshme;  
Parti! Mësuese e ideve të mëdha.  
Ma e nalta majë e pakapërcyeshme.

Flamujt, voglush ngrei nalt,  
dhe doçkat fort përplas.  
Ti, o gjysh, ço zanin ma fort,  
çiftelisë furishëm bjeri tallas.

Për ty, Parti, na sot brohorasim,  
për birin tand ma hero.  
Lavdi sa malet, përjet' të paçim,  
ndër shekuj kështu marsho!

Në Shkëlzenin e naltë, prej larg dallohet:  
 — Rroftë shoku Enver Hoxha —  
 që nga t'diellit rreze prarohet.  
 Ky asht mali vigan Enver Hoxha.

Po, edhe ky mal përmban çelik.  
 Ja, **dhe Partia**, dhe Ai, të pastër, të fortë,  
 e forcojnë posa shkamb kreshnik,  
 tue ja ba anmikut t'pahapshme portë.

Përballë meje asht portreti i tij  
 e sytë i shohin larg, larg.  
 Sikur me sy ai mat rrugën  
 e sukseseve që s'radhiten në varg.

Ballin dalngadalë ja mbulojnë thinjat,  
 që për ne janë po aq të afërtë, e t'shtrejta,  
 sa dhe thinjat e nanës që na lindi  
 e na tha të parat fjalë të zjarcta.

I dashtun ky emën, i shtrejtë pér ne.  
Në zemër na ngjall të madhe dashuni,  
pér Atë, që udhëheqës e kemi,  
pér Atë, që na jep lumtuni.

## 4

Shpërthe, vrull, mos u freno,  
sot asht e jotja ditë!  
Mes gështenjave të pyllit kalo  
e nalt ti ngjitu pa frikë.

Gëzohen sot zemrat shkodrane,  
buçasin kangët kreshnike,  
e çiftelitë formojnë një orkestër  
që mes bjeshkëve tingëllon heroike

Kalon Ai! Ja: asht mes nesh,  
dorën na jep, bisedon me pleqt;  
e sytë tanë qeshin, qeshin,  
gazi ynë e mbuloi këtë vend krejt.

Mirënlohja jonë asht e thellë,  
 si ma i thelli oqean e det,  
 dashunia jonë e pastër, e kthjelltë,  
 si lumi mes alpesh, Cem.

Unë s'linda kur lindi Partia,  
 pushkët, jo, nuk ushtonin.  
 Shtëpia s'tundej n'buçima.  
 Fashistët komunistët s'kërkonin.

Rrezja m'përkëdheli mbi ballë  
 me t'amblën puthje të nanës.  
 E shtëpia jehonte ndër kangë,  
 sepse s'luhatej mbi të hij' e natës.

U rrita unë me qytetet  
 e trup me oxhaqet lëshova,  
 e pastër, e fortë plot hekur,  
 gëzime ngajeta vëç mora.

Duert plot kallo i kam  
e kjo dorë anmikun dërmon,  
po guxoi lumninë me na prekë,  
sepse stërvitun jam n'polygon.

## 8

Vështroni diellin sa rreze shpërndan!  
Mijëra janë, t'panumërt pér mua.  
Parti, o diell i jetës sonë,  
kë s'ngrohin vallë rrezet e tua?!

Parti, sa nalt ti na ngrite  
e flatra t'fuqishme na dhe!  
Parti, o e fortë, kreshnike,  
pérjetë mbas teje na ke!

DRITA BEKTESHI

## VENDLINDJES SË KALTËR

Kur mbi shkumën e bardhë  
dhe dunat ranore  
rrrotullon përmes erërave dielli rrezet e kaltra,  
unë mbi zallet vrapoj pranë hapësirës ujore,  
ndërsa vesa u njom pulëbardhave  
krahët.

Vesa bie përmbi mua  
dhe kripet në det  
(sikur bien vetë yjet porsi luspa prej drite),  
në agimin detar, ku delfini rrëshqet  
nëpër ujrat që treten ngadalë  
në ranishte.

Dhe kështu, përmes shkumës plot ajër dhe vesës  
(i njomur dyfish dhe i kripur mes flladeve),  
unë u rrita i ëmbël,  
plot rini,

i shëndetshëm,  
sikur thitha vetë frymën  
kristal të pulëbardhave.

C'më thonë zërat e fshehtë  
të detit të madh  
për legjendat plot nimfa dhe anijet me vela,  
për detarët e moçëm që s'u kthyen  
më prapë,  
të përvëluar nga malli  
i atdheut në ëndërra.

(Kur u thyhej dyreku dhe rrufetë  
hidhnin kryqe  
si mirazh, ata brigjet i kërkonin me sy;  
duke vdekur, mes vorbujsht zgjatnin krahët e tyre,  
sikur donin t'i zgjatnin, Shqipëri,  
gjer tek ti!)

O ju vise të ngrohta të hapësirës dhe diellit,  
që kaq shumë ju kam dashur  
dhe ju dua sërish,  
zhurmojnë përjetësisht tek unë  
zërat e detit  
mbi qytetin e lashtë

plot sirena,  
që klith.

Plot sirena dhe lëvizje vaporësh në port,  
ku krahët e hekurt elektrovinçat i tundin.  
Për mua, ata këtë diell si kurorë,  
për bustin e Mujo Ulqinakut,  
ma ulin.

Rri me pushkën mes vitesh,  
si karakoll i ndritur  
(dhe prap, po të vritet, do të ngrihet i gjallë),  
dhe deti, nga toka, me shkumë i thinjur,  
mbi armiqtë do të hedhë  
shkëmbinj edhe dallgë.

Kjo është dashuria e detit për tokën,  
ku unë linda, për ëndërrat  
dhe gëzimet e njerëzve,  
për qytetin dhe brigjet, që ndritin mbi shqotën,  
mbi themelet epike të kohëve  
dhe këngëve.

MOIKOM ZEQO

## DEJEVE TË TUA, ATDHE!

Endem dejeve të tua,  
endem në vjeshtë a pranverë,  
ndjenjat më gurgullojnë si krua,  
krenaria më deh si verë.

Kridhem në këngët e tua,  
shkrihem në vallet e zjarrta,  
në shpirt më tundet parreshtur  
mirazh'i kaltërsive të arta.

Kurrë s'jam ndjerë i vetmuar  
në çdo vend véllezér ti më dhe.  
Ne jemi të gjithë degë të fuqishme  
Që dalim nga trungu yt, Atdhe.

Dhe ëndërroj nën qiejt e tu,  
ti vetë m'i ndjen ëndrrat në netët e  
kapanonit,

si kundërmojnë aromë lëndinash  
dhe tundet në to shalli i aksionit...

Kështu duke rendur hapësirave  
(Ajri i lirë m'i mbush mushkëritë)  
unë ndjej se më buzëqeshin kontinentet  
dhe tërbohen diku në qoshe armiqtë.

Shpejt do gjëmojë kënga jote  
në të katër horizontet an' e kënd.  
Në të dlinin flamur të komunizmit  
i pashlyeshëm do gdhëndet reliivi tënd.

### BARDHYL LANDO

## MOLI I DURRËSIT

Me natë e ditë lundruam  
rrrotull kontinenteve.

Nën yjet e tropikut, nën netët e qeta dhe të  
nën dritën e murrtyer të diellit dhe ja, o shokë,  
Atdheu. Molin e rrahin erërat,  
erërat e viseve të sapolara, në diellin e qashtës  
përshkojnë vinçet dhe udhëtarët që na presin,  
Britma dhe përqafime midis thirrjeve dhe  
ballamarëve,

midis hekurave dhe ankorës që ra në ujë.

Mirë se të gjej, Shqipëri! Bijt' e tu  
me krah vrapani dherave të largëta,  
lavde mbi supe mban anija jonë.

I rrahir rrymash, puth atdheun bashi.

Kush tha se jemi lodhur e drobitur?

Pa hapuni, o shokë dhe ju vallëzonjës,  
të hedhim vallen tonë, «Malanaken»,  
me zoçkëzën e bukur të nostromit.

Të hijshme vajzat tona besa-besë,

me sy e bebe aq të mrekullishme,  
Jo, s'i takova anekënd në botë.  
Të bukura kodrat e Golemit  
dhe vinçët, pelikanë sqepagjatë  
të hijshëm përmbi putrat e çelikta.  
Mirë se të gjej, Shqipëri! Bijt' e tu  
me krah vrapani dherave të largëta,  
të rrahur shkulmesh rrobat dhe kabinet  
me fllade palmash rrahur dhe bananesh  
edhe manjole madhërisht të këndshme.  
Ne kemi këtu botën në anije,  
po zgresim kontinentet buzë e gaz  
te shkallët e lëshuara mbi valë.  
Dhe rish do vijë dita kur do të shkojmë  
në oqean pafundësisht të kaltër.  
«Detar!» thërret dikush nga udhëtarët  
«Detar! Detar!» gazmohen ballamarët.

### SHEFKI KARADAKU

## DITËT ME DIELL

Erdhi stina e zverdhjes së grurit  
plot mëngjeze ngjyrar, trëndafili,  
ndoqa shtyllat pas bregut të lumit  
me kabanë, me violinë të bilbilit.

Erdhi koha që lisi i dendur  
të qendrojë pranë shtyllës me drita  
dhe buzë rrugës, ku priste dje gjaksi,  
ku vendon këmbëkryq drita e dita.

Gruri nxori kallinj të begatë,  
koh'e ngjeshur me grurë dhe me basma,  
mbi vagonat e trenit stuhihëm  
erdhën njerëzit, dritat dhe dasmat.

Jam me ta në vagonat e parë,  
kam dhe vargje dhe pinca në xhepa,

po m'i lumtur do jem köto ditë,  
kur do ngul shtylln' e fundit mbi shkrepë,

Ja prodhimet e tokës së mbjellur,  
viti i parë që prodhon toka djerë;  
kötu vjet dashuroi malësoren  
ai djali çapkën i kantierit.

Jam i lumtur në ditët e bardha,  
zbres e ngjitem në fusha e kodrina.  
Erdhi koha e zverdhjes së grurit,  
rend rrufeshëm vagoni mbi shina.

Eshtë e jona kjo tokë me taraca,  
tonat janë kombinatet dhe basmat.  
Ne vrapijmë me drepjnjë drejt fushës,  
brezi i kuq me prodhime dhe dasma.

NIKO KACALIDHA

## HIDROCENTRALI I VAUT TË DEJËS

Ti je një kolos që ende në skele je shtrirë,  
ti je aq i madh sa me këto vargje s'të mas,  
me valët e errta të Drinit të gjerë, të lirë,  
je lidhur. Flet uji me erën dhe ngrihet tallaz.

Punëtorët, nën dritën e natës së qetë dimrore,  
kërkojnë fitoren. Teknikët thërrasin. Nxitim.  
Me dit' e net atje në çukat veriore  
të pashë plot vrull dhe gjallim.

Shëtita. Nën këmbë dëgjova vringllima e qeshje  
dhe ndjeva se dita e festës s'është larg  
këtu, ku errësira e ngrirë me ujërat përleshet  
në sonda. Me yjet përqark.

SHEFKI KARADAKU

## MALESISË SË MADHE

Malësi e Madhe!  
Ke mbajtur mbi supat e tua  
trimëritë legjendare shqiptare;  
dhe sot po mban mbi shpatullat e tua  
vullnetarët me levë, varë dhe barominë,  
që hapin rrugë, sjellin dritë.

Malësi e Madhe!  
Më dhe më tepër nga ç'të dhashë unë.  
Ti për ne ishe shkollë edukimi,  
ajër i pastër, ujë i ftohtë burimi,  
dhe shumë të tjera,  
që, po t'i them,  
po t'i rreshtoj,  
duhet një poemë.

MYLAZIN XHAFERAJ  
(Instituti Pedagogjik, Shkodër)

## PËRROI I EGËR, I BUKUR, I LASHTË

Përroi rrukulliset me zhurmë nga mali,  
cërka kristali hidhen anë e kënd,  
i gjelbër përreth rritet bari,  
kurrë s'mund të gjesh më të bukur vend,

Zjen, shkumbon ndër katarakte  
përroi i egër, i bukur, i lashtë.  
Erdhi tanj kjo kohë madhështore,  
lumenjtë djersë derdhin me ne bashkë.

Po derdhin djersë lumenjtë me ne  
dhe shndrrohet djersa me fitore në rubin;  
kthehet djersa në dritë elektrike  
dhe lart, në shpate, si yll llamburin.

MIRA LINO

## PRANVERË

C'thanë ashtu lisat e moçëm  
që krahët tundnin, zhurmonin?  
Ndoshta u uruan mirseardhjen  
shokëve të rinj — shtyllave prej betoni.

Nga na vinë vallë këta tela,  
këto shina që shtrihen në ajri?  
Janë krahët e shtrenjtë të qytetit  
që përkëdhelin në fshat çdo qoshe, çdo  
cati. ; :

Pranvera endet rrugëve, burimeve,  
rrym' e shtrenjtë vrapon telave,  
zëri i radios na zgjon tani agimeve,  
jo kori i çfrenuar i gjelave.

Do të ndrrohet pejsazhi një ditë  
në pranverën që ka vërvshuar,

veç shtyllat do mbesin ato që ishin  
hamej me elektricitet ngarkuar.

Do të rendë telave për jetë  
mendimi i qytetit proletar,  
që të ndrisë të ëmblave netë  
si diell i ri pejsazhit fshatar.

### BARDHYL LANDO

## N E N D O R . . .

Sa shpejt nëndori erdhi përsëri,  
mbi flokët e mbrëmjes tela dritash derdhen,  
shqiptari vjen e sheh këtë shtëpi,  
ku më të kuqet mendime enden.

Shikimin-dritë mbi rrugë hedh Shqipëria  
dhe grushtin fort përplas mbi tradhëtinë,  
se kjo tokë të fortë i nxjerr filizat,  
që në nëndor u lindën me Partinë.

ZHULJANA JORGANXHI

## ZOGU I STUHIVE

— *Mbi tē thinqtin shesh tē detit era fryn  
e mblidhen retē.*

«*Zgalemi*» i Gorkit

Nga shqetësimet e kaltra tē stuhive detare  
vërtitet ai zog i madh  
krahëhapur  
dhe fluturim' i tij me vetëtima ndez ajrin  
mbi baticat dhe zematicat, si frymëmarrje e detit,  
që me kripë i mbush shpellat  
e shkëmbinjve tē lagur.  
Dhe, papritur, erërat e ngrenë  
prej bregdetit  
aq lart, sa çdo gjë në miniaturë e sheh  
dhe herë mbi dallgët mes stërkalave njomet,  
dhe i lirë fluturon në lirinë e vet  
(çdo element i natyrës,  
nga gazi i tij,  
gëzohet!)

Ky zog,  
më madhështori i zogjve të qillit,  
është figurë e vetë jetës në shqetësim  
të përjetshëm

i ndryshimeve,  
vrulleve.

Në gjoks të planetit,  
në horizont ku çfaqet,  
në pesë kontinentet,  
ky është zogu që fton për revolucion  
dhe përleshje.

Atij Gorki i këndoi si trumbetar i së ardhmes  
mes stuhive mbi detin e gjakut dhe urrejtjes.

Këto s'janë veç vetëtima,  
po shkëlqime armësh  
mbi kapitalin që s'gjen udhë.  
Në udhëkryqet  
e vdekjes.

Le të ngrihet prap Gorki të këndoje për zgalemin  
mbi Evropën plot mjegull,  
intriga dhe natë.

Mbi tradhëtinë dhe zinxhirët, proletarët  
do sjellin

stinat e fitores

së komunizmit të madh.

O zog, që fluturon mbi tragjeditë e shekullit!

Revisionistët po mbyten  
në anjen e tyre.  
Ky është revolucioni  
i horizonteve dhe diellit,  
ku e ardhmja si ylber lind  
nga mitra e stuhive.

MOIKOM ZEQO

## I PLAGOSURI

Atij mos i thoni  
që shokët sot do luftojnë,  
se ndryshe u hodh nga barela  
me shokët gjoksin të bashkojë.

Atë me këngë e gënjeni,  
ndryshe s'ka si shkon,  
që edhe ai të këndoje bëjeni,  
se ashtu zemra i gufon.

Atij mos i thoni  
që shokët i thërret lufta,  
se ndryshe si zog do t'ju shpëtojë  
ai nga barela.

ASTRIT NURI

## TROMPETË E ALARMIT NË RËNTË

Ne u njohëm sërish për t'u ndarë,  
si dallëndyshet nëpër atdhe të fluturojmë.  
Ne jemi të atdheut ushtarë,  
trompet' e alarmit, në rëntë,  
në front të parët do shkojmë.

MIRA LINO

IBUN TISTEA

## NE ERDHËM PAS TEJE

Ne erdhëm pas teje  
netëve partizane.

Kënduam me ty,  
netëve të errta,  
këngë rreth zjarreve

Ne erdhëm pas teje,  
në shkepe të thepisura,  
duke kënduar këngët tona,  
duke kapërcyer shkëmbenjtë,  
si hëna që bredh netëve,  
mbi gurët e maleve,  
Rrezet e saja.

Ne erdhëm pas teje,  
në rrugën leniniste,  
se e dinim që do ishe  
heroikë e ditëve të stuhishme,  
heroikë e ditëve të qarta marksiste.

KLEMENT ODRIÇANI  
(Instituti Pedagogjik, Shkodër)

## KTHIMI I SKENDERBEUT

Turma e kalorësve  
ngrinte re nga dheu,  
në trollin e mëmës  
erdhi skënderbeu.

Korbat lanë bedenat  
dhe ikën në qiel,  
gjysmëhën' e mplakur  
dridhej mbi kështjellë.

Çallmëbardhët heshtën,  
heshtën si kufoma,  
shqipet ngritën grushtet:  
«Toka është jona!..»

Retë u arratisën,  
toka thithë diell,  
shqipja arbërore  
ndriste mbi kështjellë.

RAKIB LASKU

## UNIFORMA E BLERTE

Në sup i kemi hedhur karabinat,  
si shokë pranë vetes i mbajmë fort,  
që kurrë mëngjezet tonë kaq të kaltra  
mos t'i helmojnë me napalm dhe barot.

Kemi aq këngë që ngremë dhe ndizen flakë,  
nga krisma e huaj këngët nuk vriten,  
me armë në duar në llogore shkojmë,  
si prindërit pranë armës nëpër vite.

Tabela ngrihet tutje, mbi një breg,  
çdo pikë e zezë do zjarr, me flak të ndizet,  
gradim shënjestre, pushkën mbajmë drëjt.  
Dhe dridhen nga gëzimi këto vise.

NIKO KACALIDHA

## PËRSHËNDETJE BASHKËFSHATARËVE TË MI

Atje, në jugë, mbi malet ndera tela  
përmbi lumenjt, ndanë bregut Jonian,  
motivi i përjetshëm do më mbetet  
në zemrën time thellë, motivi zgjarr.

Kishim një lum' me gurë e katarakte,  
tashti pranë tij u ngrit hidroçentral,  
ku fijet elektrike lidhin shtyllat  
ku shtyllat ngjiten, ngjiten përmbi mal.

E mrekullueshme pranë fshatit zbriti mbrëmja,  
o ju të shtrenjtë, të dashur bashkëfshatarë!  
Pranë radios, motra e madhe son te ulet,  
radion hap dëgjon vargjet e vëllait...

Në mbrëmjet e ndriçuara, të bardha,  
(ku kishit parë ju më parë kaq drithë?)

vallzojnë bashkëfshatarët me qeleshe,  
gëzojnë, me qingjat qafës, dhe barinjtë.

Lavdinë në valle e derdhët ju të shtrenjtë,  
sonte gëzimin bashkë me dritat derdhët,  
si nga fontani i madh që veson malet,  
buron lavdi, gëzim dhe dritë për herë.

Ej, vogëlush, që sheh plot ditë të bardha,  
gëzimi i madh i fshatit të përkund!  
Sonte dhe mali duket, nga gëzimi,  
sikur kupën e hënës pi me fund.

Atje, në jugë, ku kam kujtimë mijrë,  
ngritmëm në brigjet një hidroçentral.  
Si glob i madh ndriçojnë mendimet tonë,  
o ju të shtrenjtë, të dashur bashkëfshatarë!

NIKO KACALIDHA

## SHTËPISE SHKODRANE

Ti, shtëpi e vjetër shkodrane,  
rrethuar me mure, me avlli,  
fsheh një të kaluar plot maraze,  
fsheh një ferekhe, një histori.

Fsheh një ferekhe, një zemër vashe,  
që kish shumë ëndrra në rini,  
hedhur një çarçaf mbi trup'ë bukur  
mos e shohin rrugës djemptë e rinj.

Mban një histori nga lufta e madhe,  
që bëm'ndër shekuj për liri,  
epope nga lufta çlirimtare  
që e bënë djemtë e tu, shtëpi.

Po, shtëpi e vjetër, ji e gëzuar,  
kur shikon apartametin e ri,

kur i shikon vajzat belkëputura  
as me ferekhe, as me shami.

SOTIR TERPO  
(Instituti Pedagogjik, Shkodër)

(Kur i shikon vajzat belkëputura)

Kur i shikon vajzat belkëputura  
as me ferekhe, as me shami.  
Kur i shikon vajzat belkëputura  
as me ferekhe, as me shami.

Kur i shikon vajzat belkëputura  
as me ferekhe, as me shami.  
Kur i shikon vajzat belkëputura  
as me ferekhe, as me shami.

Kur i shikon vajzat belkëputura  
as me ferekhe, as me shami.  
Kur i shikon vajzat belkëputura  
as me ferekhe, as me shami.

Kur i shikon vajzat belkëputura  
as me ferekhe, as me shami.  
Kur i shikon vajzat belkëputura  
as me ferekhe, as me shami.

ALBA LILAKA

SOTIR TEFPO  
(Tirana, 1950)

## MARSHON GJITHMONË ME NE

*(Mësuesit Ismet S. Bruçaj)*

Ti ecën dhe shpejton, ecën, po të presin,  
e ndjen se i ke pranë, me ta një zemër je.  
Një libër dhe një radio, hedh çepet përmbi male  
era tund dhe lisat, po jo zemrën që rreh.

Në gryka ulërin, era fryn e tërbuar.  
Radio Tirana më fort veg kumbon.  
Eshtë zëri i Partisë që zjarr, shkëndi, ndez zemrat,  
ndaj ti dëgjon i lumtur, ecën dhe marshon.

Të presin ato foshnja te der'e shkollës fshatit  
ti librin mban në duar, u duket se spjegon.  
Të presin ata sy, ti je për ta i shtrenjtë.,  
Tufani të rreh gjoksin, Tirana transmeton.

Ti s'munde t'i takoje, mungoje në apel.  
Vigan mbi ato male u ngrite, ndonse re,  
i kuq me librin pranë, me zërin e Partisë  
i gjallë jeton, mësues, marshon gjithmonë me ne.

VERA LLAKAJ

## MËSUESI YNË

Ku shkon kështu mësuesi ynë,  
kështu në shi, ku shkon?!  
Shih, erërat e marra fryjnë  
dhe ulurijnë mbi hon.

Po ngjitesh shtigjeve malorë  
në fshat për festë të mbrish.  
E librat, radion mban në dorë  
Dhe ec e ec sërish.

Ti, mund të rrije në qytet  
pranë sobës sot i qetë,  
por rënde lart, mësues Ismet,  
Se tërë fshati të pret.

Në gji fletthirrjen për shërbimin.  
ushtar, mësues, do shkoje,

por deshe dhe një herë mësimin.  
fëmijve t'u shpjegoje.

Dhe frynin erërat e marra,  
ti befas... shkave, re.  
Një çast i zgjate duart para,  
sikur na i zgjate ne.

Mes nesh, të mbetën mijra ëndërra.  
q'u ngritën lart mbi hon...  
Nga larg dëgjojmë, si rreh zemra  
dhe radiua këndon.

### FOTAQ MALO

## AKSIONISTJA E PËRJETSHME

Ti u ngrite mbi vdekjen  
mbi dhimbjen dhe legjendat.

Dridhen çiftelitë  
dhe valët e radios,  
se atje  
në trasetë e hekurudhave të reja  
u shkri imazhi yt përjetë  
me të Rozafës.

S'të pata njojur kurre  
dhe pranë tani  
të ndjej.  
Në pavdekësi ti shket  
mbi qiejt si kometë,  
sa herë që motrës flokët ngadalë  
ja përkëdhel  
më duket se ty flokët me dashuri  
t'i prek.

Dhe sytë që të qeshnin,  
tiparet e fytyrës  
i gjej në çdo fytyrë të shokëve  
të aksioneve,  
se ti mes tyre mbete,  
në krye të detyrës  
me kokën e mbështetur  
mbi këngën e rapsodëve.

Dhe sytë pa frikë i mbylle  
nën erën e nëndorit  
(Një ditë të tillë nëndori  
këndova për Ademin.)  
A nuk i ngjet ky muaj më tepër  
një stacioni  
ku kohërat çdo vit  
heronj të rinj na sjellin?

Dhe bjeshkët që të lindën  
nga dhimbja u tronditën  
dhe me rrufe të zjarrrta kurorat  
lart t'i hodhën.  
Që gjer në fund të zinte  
vendin bosh së bijës  
u ngrit malësori trim,  
me mijra pas  
e ndoqën.

Dhe hapi i rëndë i tyre gjëmon  
në largësi  
sikur gozhdon mbi udhët  
kanunet e së vjetrës.  
Dhe ti e zjarrtë shfaqesh  
në jug dhe në veri,  
në horizont  
Me flokët e çpleksura prej erës.

... Edhe një ditë të ngrohtë  
do shkasin mbi binarët  
vagonët duke ndjekur nga pas lokomotivat  
(Siç ndjekin pas të bindur  
një titull vjershe vargjet).  
Dhe emrin tënd do thonë mbi fusha  
fishkëllimat.

Dhe ti do jesh fener në kryqëzime linjash;  
në tymin e trenave  
do tundësh  
flokët e butë,  
dhe rrrotat do këndojnë të rënda  
sipër shinash:  
Shkurtë, Shkurtë!

MOIKOM ZEQO

## KUJTIM PËR SHKURTEN

U nis ajo...

La bjeshkët, në aksion të shkonte.

Partia e kish thirrur cucën malësore,  
që zemra i gufonte.

Shkurta ra.

Nuk vdiq ajo, që shumë e donte jetën.  
U bë flamur, kur andrrat i qëndiste  
malësorja trime,  
e vogla komuniste.

Hekurudha zgjatet.

kilometrat njëra tjetrën pasojnë.

Qindra do të vinë, me hov do punojnë,  
me këngë në gojë:

– O partia jonë!

Flamujt shpalosen.

Në tokën e ngjeshur kazmat futen.

Busti buzë trasesë mbetet  
kujtim për Shkurten.

SHKENCA ALLTARI

## AJO DHE KËNGA

Kënga  
është si uji.

Po pati vend,  
mer vrull;  
po gjeti shtrat,  
bëhet lumë.

Për ty, Shkurtë,  
kënga pati vend trasenë  
(ku dhe treni i hekurt  
e jo poezia, vrull merr).  
Shtrat heroizmi  
jeta jote u bë.  
Nuk them ti,  
se ti dhe heroizmi jeni një.

Ti re,  
po u ngritën me mijra,  
sa t'i numroj nuk mundem unë.  
Ti re,

po u ngrit Shqipëria gjithë,  
me ty dhe Fuat Çelën flamur.

Kur treni për në Fier të kthejë  
në hekurudhën e rinisë  
Veri-Jug,  
unë  
dhe ty do të shoh si pjesë të tij,  
si këngë, si hov — në turmë.

VLADIMIR GABA

(Instituti Pedagogjik, Shkodër)

## DJE DHE SOT

Gruaja më parë, Dija e di,  
mes mureve të errta rrethuar.  
Mbante fytyrës çarçafin e zi,  
zakon i keq në shoqërin' e shkuar.

Dielli lindi, pushka krisi,  
dje rroku pushkën, çarçafin grisi.  
Marshon me burrin sot krah për krah  
n'uzina, fabrika, aksione të mëdha,

Leksione mban, në mbledhje merr pjesë,  
më hap të sigurtë po marshon.  
E socializmit është ajo krijesë,  
e jetës së re në vendin tonë.

AVNI RUSTAJ

(Instituti Pedagogjik, Shkodër)

## TI...

Ty s'të foli baba atë natë,  
veç vështrimin rreptë në sy ta treti.  
Nuk e priste, që ti, vajz' e parë,  
me guximin tënd të dëboje mblesin.

Ti urreje mblesët matrapazë,  
fjalët e tyre — kënetë,  
ku si lule ëndërrat s'mbinin dot.  
Ndaj e ngrite grushtin me të shpejtë,  
që nga gaz'i mblesit  
mos gëlltisje lot.

ZHULJANA JORGANXHE

## M I R A

Mira!

e thërrasin shkurt të njohurit  
dhe me dashuri e përshëndesin.

Çdo ditë ajo ecën e qeshur,  
e freskët në ditët e freskëta.  
Ku gjendet, ku mund ta kërkosh atë?  
Sot partia e ka caktuar të ndjekë  
leksionet në auditore,

nesër  
ajo do të jetë  
në gjirin tend edukatore  
atdhe!

Në sallë të studimit një shoqe pranë i kalon.

- Ç'bën, Mira?
- Po pregatis një seminar  
të Historisë së Partisë.

Dhe vazhdon të shfletojë  
fletë nga historia,

e zhytur në ata rreshta të shkruar  
me gjak.

. . . . .

**Lexon gazetën «Koha»:**

«Lumtërisht doli në botë  
xhaxha Lenini».

**Dhe Mira**

do të shqojë atë çast:

«Lumtërisht

u krijua në Shqipëri  
Partia».

Kështu rritet një jetë e pasur,  
që pasurohet,  
jeta rinore, që krahëhapur  
thith ajër,  
ajrin e pastër të hapsirës pa fund.  
Ajin që pastrohet  
ndër pranvera.

**Pranverë!**

Qeshu me të,  
qeshu me ne!

Se edhe ne me të  
gëzimin përzjejmë,  
si përzjeu Shkurta gjakun  
me kokrrizat e vogla  
të dheut në trase.

**ELEZ PEPOSHI**

## PËR GITËN

Vendosa kësaj radhe  
të shkruaj për Gitën.  
Asht shoqja jonë, që kanunin ka vra.  
Sa herë që e takoj, un' ja përmend ditën,  
kur u ngrit e foli  
për «Fishekun në pajë».

Drama që po flasim  
asht, o motra ime,  
drama që t'ka ndodhun pak kohë më parë,  
Vajzë fort e thjeshtë, me faqet thatime,  
na solle një temë  
të re në seminar.

Nga katedra e tij  
kish ardhun pedagogu  
dhe qe ulë mes nesh e na vërente në sy:  
Sot fjalët e Gitës nuk janë si kangë zogu  
të cilin n'kafaz  
e mbajnë ndrye,

Dëgjonim t'kaluemen  
zeher tuj gëlltitë;  
ne na rrihte zemra e merrnim betim.  
Si na mëson partia, përgjithmonë, o Gitë,  
do t'jemi me ty.  
**Për emancipim!**

DIMITROV POPAJ

(Instituti Pedagogjik, Shkodër)

## MIRUPAFSHIM, NANË!

Agimi i freskët,  
si nuse malësore,  
kreshtave po u fshin të natës pluhun.  
Sonte, nanë e dashun,  
fjete veç pak orë:  
për aksion po nisem edhe unë.

Në heshtje nata shkrihej  
(këndonte veç çentrali)  
e n'kaltërsinë e thellë dridheshin tyjet.  
Ti akoma s'flije,  
dhe një mollë ma tepër  
fshehtas meje në valixhe shtije.

Tash po nisem...  
Gëzimi që djali  
t'u ba me e përcjellë, më vesë sytë t'i ngjeu.  
Po dhe m'i ngul sytë dridhshëm:

i trembesh ti syzezës  
që gërshetin gështenjë e preu?!

Mirupafshim,  
mos u tremb, nënoke!  
Kur mbi Myzeqe,  
si një lijen i kaltër nata do të derdhet.  
N'mes shokësh e kangësh-hekur,  
me kangë në buzë e n'shpirt,  
yt bir fort i lumtun trasesë do të kthehet.

Ndërsa ti do të zbresësh tek 'ahu i vjetër,  
me enën e ujit në burim.  
Si krah shqipeje  
shaminë ta merr era.  
Ndërsa thinjat  
kunorë të rrinë.  
Dhe ashtu do t'më shohësh,  
në shtegun me pisha,  
ku po derdhem unë si parëverë.  
Krenari e ashpër  
muzgut do të t'ndrisë.  
Kështu shumë përcolle,  
e prite shumë herë.

Dhe kështu dhe mue  
sa herë do m'përcjellësh  
këtij shtegu me pisha,  
në këtë agim.  
nëse atdheu ynë të dyve na thërret,  
ena e ujtit  
le të rrrijë në burim...

MEHMET ELEZI

## NJË DITË NË TRASE

Karrot e dorës venë e vinë,  
karrot midis shinave lëvrijnë,  
një turist qendron si piketë,  
heshtja e mbulon, ai s'flet.

Në blok diçka ai shënon;  
— Turist, hej turist!  
Këtu s'ndërtohet piramidë për  
faraon,  
po lumturia e një populli 2 milion.  
Këto zemra e këto karro  
këtë thonë.

...daxiq qillari i ëja  
...nëtësiaj tjetri si nde evitësiaj i nj  
...qiliqisëq i doliq  
...siller emrave ngrënës sotë o është e

## SONTE NË SEKTOR

Sektorit sonte endet poezia,  
si fillad i freskët luleve n'rudinë.

Derdhuni të gjalla  
mbi vargjet e mia  
ti vrull-yullkan,  
dëshira rinore,  
si nji shi i ngrohtë  
barit që bulon një vetull malore.

Sektorit sonte endet poezia,  
flaka e rinisë  
djeg muzgun e natës.  
n'barakën pranë rreh flatrat një kangë rinie,  
kangë që, në mes vrullit,  
erë djersë bie,  
afsh përvëlues të barutit t'thatë,  
pavdekësi të komunistes Shkurte Vata.

Sektorit sonte endet poezia.  
Sektori sonte,

një i rrallë peizazh:  
ku kreshtave shtrin krahët kaltërsia,  
gjethet pëshpërisin,  
e rreptë e rreh bregun deti me tallaz...

MEHMET ELEZI

## TI U NGJITE

Ti u ngjite nga thellësitë e shekujve,  
nga mesjeta mbërthyte me kanune e zakone.  
Dhe ashtu, pa trokitë,  
u fute në ditët tonë,  
si një shpend i fuqishëm që mbi shkrepët  
nga thellësitë e errëta,  
të fshehta  
të një honi.

livadhesh ndante flladi erë lulesh pranverore.  
I harkët ylberi,  
si gjerdan fishekësh,  
mbështjellej krahnorit të ashpër të një kodre.  
Dhe ti nuk e preve gishtin e vogël  
që ta kaloje atë,  
që të baheshe djalë,  
e prap, në radhët e kangëve e regimenteve tonë  
kreshnike u fute,  
si një lumë me valë.  
Dhe përsëri u ngjite në malet e tua,  
në t'lashtën kullë mes ahesh hyne përsëri.  
Ti hyne kryenaltë,  
megjithatë, kryet ule:  
fliste radio e' porsableme  
për kthimin tand në malësi.

### MEHMET ELEZI

## KURRË S'TË NDAVA NGA KËTO VISE

Vise të kaltra, të kaltra,  
kaltërojnë ëndrrat e fëminisë,  
sa i pastër syri yt, sa i pastër,  
baluket mbi ball' si petalet e qershish.

Ç'hedh ashtu e lehtë si drenushë?  
Ç'hedh ashtu ngadalë sipër koke?  
Oh, ç'më ngjaka shall' i aksionit larush  
Sikur hedh muzgjet, agimet e kësaj toke.

Ndaj kurrë s'të ndava nga këto vise,  
ndaj të dyve ju desha barabar,  
tej këtyre horizonteve ti s'do ishe  
kaq e freskët, me syrin qelibar...

## BARDHYL LANDO

## DIELLI IM

Dielli shkëlqen e ne na ngroh,  
dielli me rrezet na jep jetë.  
Kudo që të jesh në vendin tim,  
diellin e kuq s'e zenë retë.

Dielli ynë i kuq po ndriçon botën,  
ngrohtësia ndihet në çdo vend.  
Dridhen nga këto rreze vec ca njerëz,  
që s'i ngroh ky diell, po i tremb.

Dielli ynë e ngroh më shumë negrin,  
kaçurrelat përpjetë ja ngre.  
Është dielli që tronditi botën,  
është dielli ynë, që po shkëlqen.

SOTIR TERPO  
(Instituti Pedagogjik, Shkodër)

## V A R G J E T   E   M I A

Ta shkrij kështu vargun dua  
si burimi i bukur i malit.

Ta mbush me këngët e mëngjezit,  
të përvëlojë si zemr' e djalit.

Të jenë kështu vargjet i dua  
si tela të rëndë tensioni.

T'i mbushim me aromën e vjollcës,  
Të ngajjnë azgënë, që kthehen nga aksioni,

MEDIN ÇELA

(Instituti Pedagogjik Shkodër)

## VARGJE NË MËNGJEZ

Babi im është ushtar,  
dhe unë  
dhe ti  
jemi ushtarë.

Ne  
na zgjoi këng' e Republikës,  
fytyrat

na përflak dielli,  
zëri mplekset

me tingujt e fabrikës  
dhe hapet në qiel  
si fashë ylberi.

Mëngjezit  
zgjohemi me marshime.  
I duam tingujt,  
që sirena përhap.

Unë dua të jem  
si këto mëngjeze,  
që me hove kantieresh  
rendin krahpërkrash.

Në mëngjez s'tregojmë  
ç'pamë në ëndërr.

Ne themi:

«Sot inaugurohet dhe një vepër,  
bie një hero,  
shpërthejnë mijra zemra,  
shkelen zakonet e kanunit të vjetër!»  
Mëngjezi vjen  
me një vepër të re.

Mbi mëngjezet dhe veprat  
lind një varg.

Atdheu

më tepër zbulohet me ne.

Ne ëndërrat  
t'i ngremë sa më lart!

## VLLASOVA MUSTA

## STUDENTI NË FSHAT

Shkoj mes kreshtash nën erën që çmendet,  
dhe tër' mall them një këngë të qeshur.  
Majëmalet me bryle thyejn'retë,  
sikur këmishën e grisur po zveshin.

Zë këmborësh. Baresha e fshatit  
më del para e lehtë si flutur.  
Shkoj mes qingjash dhe syve të saj  
sikur zbret një përrallë e bukur.

Më pret nëna në breg të qershive.  
«Hej, student!» flet dikush nga një skaj,  
nga traktori zbret fqinja e bukur  
dhe më puth si vëllanë e saj.

Zbres me nënën në fushën e gjerë,  
era retë si mjelma lëkund,  
në punë derdhen gjëzimet e mia,  
hapësirës së gjerë, pa fund.

LLIKO NANO

## KËNGA E ELEKTRIÇISTËVE

Ngrem' pareshtur shtyllat elektrike  
maleve plot këngë dhe jehona,  
do të rrjedhin lumë elektronet  
dhe do ndezin buzëqeshjet tona.

Nëpër supa tela, izolantë.  
Ç'do të donin këto male tjetër?  
A nuk janë këto llambat tona  
porsi predha mbi botën e vjetër?

LLIKO NANO

## NË KISHË

Shqyhej nga gazi një harmonikë  
dhe këmbët shkelnin kudo mbi altar.  
nuk pashë atje as 'heshtje, as frikë,  
as dhe njerëz të zymtë besimtarë.

Prifti mbërthente duart në kokë,  
sikur donte të ruante logjikën «e parë»,  
dergjeshin shtrirë, të shqyer përtokë,  
kryqat e zinj, si korba të vrarë.

Pashë të këndonte rinia fshatare.  
Ej, si kërcehej prej tyre «Valbona»!  
Shkrihej bloza e zezë mesjetare,  
dridheshin mure të vjetër e frona.

Dhe u futa ahere në valle,  
«Ranë kishat», krenar unë thashë,  
tundej flaka si shami ngjyrë alle  
mbi ikona dhe libra të trashë.

RAKIB LASKU

## MËSUES

Për ty, mësues, zemra më thotë  
dy fjalë të shkruej e jo më kot,  
po due të të thur një kangë me kreni,  
ty, që preqatit brezin tonë të ri.

Sot ty partia të ka dhanë në dorë  
një armë të fortë — je edukator  
ti, fenerndriçues i rrugëve të reja,  
ty, që s'të tremb lodhja dhe as vdekja.

Pra, më lejo, o ushtri e mësuesve,  
t'ju uroj festën ju, dritëçuesve,  
në skajet e atdheut ku mësim jep,  
ku zani i dijes melodioz buçet.

Dhe në varg me ju nesër do të jem,  
me vrullin e ri që përshkon atdheun,

dhe do të marshojmë drejt majave të nalta,  
shtigje të reja atdheut tue i hapë.  
**Pra**, nga zemra festën ju uroj,  
dhe s'shpejti me ju unë do të jem,  
    të marshoj,  
tue mbajtë në dorë armën më të re,  
pushkën, kazmën, librin për jetën e re.

BAJRAM TAHIRI

(Instituti Pedagogjik, Shkodër)

## M E S U E S I T

Gjithmonë do të shkruaj për malet që i njoh,  
për t' ardhmen e bukur që i rreh pa pushim.  
Për t' sotmen e madhe, që në male ngroh,  
si pishtar partie, ti, mësuesi im.

U frymzova me shkrue sot n' festën tande  
një poezi të thjeshtë e të dashtun lirike.  
Më lejo, mësues i dashtun, kësaj radhe  
t'i shkrij për ty ndenjat e mia poetike.

Kështu andrroje veten mes vocrrakësh,  
kur ambël do çojnë duart përmbi bankë.  
Me to mësues kurrë s'mund të mplakesh,  
se fort e njomë asht e tynia kangë,  
kangë shkëndijash që sillen rreth flakësh.

DIMITROV POPAJ  
(Instituti Pedagogjik, Shkodër)

## SPORTISTJA E RE E LAGJES

Në mbrëmje, në shtëpi vonë ktheheshe,  
nëna te praku të priste,  
as çantën sportive prej shpine s'hiqje  
kur ajo çirej: — Bijë, na turpërove!

Në mbrëmje vije veshur me tuta.  
— Bijë, mjerë kush do të marrë,  
më mirë mortja!  
Por ti qeshje, nënën e puthje,  
nënën, që e vrishnin mendimet e kota.  
Dhe zbardhur ishte parakohe  
nga zakonet e vjetra.

— Nënë, shihe vajzën tënde sot në gazetë!  
— Bijë, për ty ky është nder, edhe për mua!  
Dhe për herë të parë ndodhi që bijën e vet  
nëna e puthte të veshur me tuta.

ASTRIT NURI

## LETËR NGA AKSIONI

Unë do të vij,  
patjetër do të vij,  
do të tregoj gjith' këngët e aksionit.  
Ato janë shumë,  
qindra dhe mijë,  
siç jemi dhe ne,  
bij' e revolucionit.

Këtu çdo gjë për neve është këngë,  
dhe këngët... ti e di, ne i thurim vetë.  
Me këngët tonë zbritëm dhe ylberin,  
e shall aksioni ja vumë në gushë trasesë.

Sot diellin përshëndetëm,  
që sytë apo çeli,  
papritur, hapin çdonjëri e ndali.  
Ç'bukuri pamë në këto orë mëngjezi:  
dielli, në «liqen», si shatrivan zjarri!

(Mos tē jam dukur vallë delikate?  
Ti do m'i shohësh t'ashprat kallo n'duar.  
Bashkë me shokët, në një turn nate,  
hej, sa shumë beton kemi gatuar!)

### Kudo me këngë

ne na gjen patjetër,  
armën shtrëngojmë kur vimë prej punës.  
Përgatitje ushtarake syrin në shënjestër  
Që zërin e çjerë mos t'ja njohim luftës!  
Tani, që treni  
shkon me pasagjerë,  
fluturon ai, duke i sjellë këngë tē reja fushës  
Ne buzëqeshje shpërndajmë,  
si ngjyrat në pranverë,  
n'horizont shkëlqen  
kontur' i kazmës dhe pushkës.

Unë po vij,  
pritmë,  
ja, po vij,  
sulmuese po kthehem prej aksionit.  
Kështu ne do montojmë yje mbi shkëmbij,  
lart t'ja ngremë flamujt revolucionit.

VLLASOVA MUSTA

## MËNGJEZI I PARË I PUNËS

Këtu s'ka salsa dhe leksione  
dhe shtrat studenti  
plot përtesë.

Këtu ti je ushtar që zgjohesh  
në orën

4.05

Hop!

Dhe në këmbë që të gjithë:  
S'ke ku të shtriqesh, fërkohesh si maçok,  
pa lindur dielli mirë  
agimi na thërret, o shok!

Ç'leksion i bukur  
ky mbi tokë,  
Kur kazma ulet mbi një breg!

Metal

dhe djersë  
dhe forcë  
enigma zgjidhet shpejt e shpejt.  
S'do mend, ne lodhemi të gjithë

kur dhé i thekur  
avullon,  
por pikërisht kjo sakrificë  
dremitjen shtrigë  
na e zbon.

## NATA E FUNDIT E AKSIONIT

Harmonikë, harmonikë,  
këngë, plepa rrëth e qark!  
Nën akasjet dhe lajthitë  
qeshin gocat cak më cak.

Nat' e fundit dalngadalë  
po afrohet në mbarim.  
Eh, ç'rumuze, zëra, fjalë  
sonte vonë në fushim.

Kush s'e deshi këtë natë  
dhe nuk ndjeu pak trishtim?  
Puthje, lamtumira bashkë  
enden fushës pa mbarim.

SHEFKI KARADAKU

## ROJE NATE

Nëpër natën me hënë të zbetë  
vetëm filli nuk fle hapi im,  
i gatitur me arm'e fishekë,  
sonte ruaj qytetin alpin.

Flenë çadrat, shkëmbinjt, hapësira,  
vetëm ujët e Cemit nuk fle,  
Ritenëndërra të bardha me mijëra,  
syrit tim nuk i fshihet asgjë.

Pa, në çfaqet një hie e huaj  
të thyej' èndrra të lira dhe jetë,  
me plumb vdekjen në ballë ja shkruaj,  
ja derdh plumbin mbi gjak si shigjetë.

Numron valët ahishta mbi lumin,  
unë pas çadraш të zemrave rrashjet.  
Ç'krenari të shkelësh mbi gjumin  
dhe të ruash nga hasmi frymëmarrjet!

RAKIB LASKU

omia minagui idarëtë pëqjess është vërtetë  
zogħallibrox i kseġġabha  
, u dha sejja  
broad idarëtë

## DETARËT

Ne jemi detarët,  
bijtë e tokës dhe ujit;  
ne shtrëngatat na fshikin në tē ftohtin e acartë.  
Ne na kripin ujrat, që horizontet  
mbushin,  
dhe shkumëzimi i valëve,  
si dritë yjesht tē ngjeshur, që tretet si re.  
Në kaltërsinë e shqetësuar tē detit, krenare  
shket anija,  
dhe malli i vendlindjes, mbi ne,  
me diellin e madh amëtar  
na përcjell.

OGRE MOKKOM

Ne jemi detarët,  
bijtë e tokës dhe ujit,  
bijtë e diellit dhe ajrit si kristal i tejdukshëm.  
Sado larg që ne ikim në oqeanin pafund,  
ja dimë mirë koordinatat  
mëmëdheut gazmor.

Në katart të anijes, përmbi flamurin, skuq  
mëngjezi i vendlindjes  
gjer këtu,  
përmbi bord.

Ne jemi detarët,  
mes shtegëtimesh u zbardhëm.  
Nga tropiku në pol, nën musonet,  
tajfunet,  
nga kontinentet dhe fiordet,  
arqipelagët e largët,  
me anjen u endëm,  
me kompasin dhe busullën.  
Ne u endëm kudo dhe nuk pamë si ky vend,  
si bregdeti i Shqipërisë së moçme nuk pamë.  
Dhe anija çan dallgët,  
si të ish një copë breg  
i atdheut në ujrat pafund  
dhe paanë.

### MOIKOM ZEQO

## QYTETI IM

Natë...

Puhia lehtas detin e përkund,  
ndërsa unë, qyteti im,  
portretin tënd ëndërroj. Mendimet shkund.  
Për portretin tënd,  
Që leva, çelësa, pistoleta mban në duar;  
për portretin tënd  
me fabrika, uzina, kombinate mbi supa rënduar;  
Për portretin tënd  
me të pagjumët, që madhështinë të ruajnë.

VLADIMIR GABA

(Instituti Pëdagogjik, Shkodër)

## BISEDË ME MAJAKOVSKIN

(Për poezinë dhe politikën)

Tetori erdhi përsëri  
me erëra, brerime,  
kadenca e gjethve që bien,  
të sjell ndërmend kujtime.

Tetori erdhi përsëri.  
Sa ftohtë që ndjen pranë bustit,  
o burrë i ndershëm, Majakovsk,  
që erërat përbuz!

Tetori erdhi përsëri  
në vendin tënd me shira,  
tradhëti e tmerëshme rrëzoi  
ndjenja, ura, dëshira,  
**Ej**, Majakovsk, ç't'u rrudh balli  
mbi vargun bomb e flamuar,  
**sa i urreve ti kolltuqet**  
me poetucë të majmur!

Ej, Majakovsk,

me zërin tënd të mbushur  
dil përsëri me poezinë  
në fushë për t'u përleshur!

Ke për të parë si do stonojnë  
ata me zë të mekur.

I tmershëm çohu ti mbi ta  
me vargun tënd të hekurt.

A mund të ulet zëri yt  
i madh, o komunist,  
kur në atdheun tënd poetët  
vetë klasës i bëjnë bisht?

Tani duhet një grusht i tmershëm,  
e dimë fort mirë, e dimë,  
duhet një daltë e fortë, Vollodja,  
në vendin sovjetik,  
t'i turret aristokracisë,  
si në shtatëmbëdhjetë,  
dhe vargu yt si lum'i rrjedhshëm  
midis stuhisë të jetë.

Kjo vjeshtë e verdhë shumë gjethe shtroi  
me shira dhe acare  
dhe stepa ruse gjak nxjerr, gjak,  
si koh' e murme e carve.  
Ku jeni, burrat e Rusisë,  
në netët ruse, burra,  
në stepat me kavalerinë.  
Trima, prapë ndizni urat.

Të ndizen dhe në vargjet ura,  
vullkan revolucionet.

# Ç'thotë Majakovski? O ç'të thotë?

Po ti do ngelësh zjarr i madh,  
              ylber i ndezur rri mbi glob;  
s'të ftoh kurrë lehja e tradhëtisë,  
              s'të grin thëllimi me galop.

Vargu është bombë, o Vladimir,  
dhe prapë do të pëlcasë,  
mizerje e zveshur tradhëtia  
s'ja ul kurrizin masës.

Vargun tē mirë e deshe ti  
pranë tokës dhe kombajnës,  
tē huajt meken si një zilkë  
n'gjëmimin e kambanës.

Duam stuhi dhe uragan,  
vargun e klasës duam

Ku ka më mirë për klasën vargje  
se sa vargjet e tua?

Dhe vijnë e thahen stepat ruse  
nga xhazi i marrë i perëndimit,  
nga tymi i puros së borgjezit,  
me viski e vodka dimrit.

Le tē gjëmojnë prapë Aurora  
edhe Ivani rus,  
tē tundet stepa që venitet,  
zinxhirat t'i këpusë.

Dhe prapë me ta, si top i hekurt,  
me vargun tënd do rendësh  
si një furtunë që ngrihet shpejt  
me vorbulla mbi dete.

Zhudukuni tutje tradhëtarë,  
posi kallam kënete!

E tmershme t'ngrihet me gjëmim  
furtuna proletare,  
t'i mbys' xhambazët që e shesin  
atdheun për pesë pare;  
t'i mbys' ata që cicërijnë  
për shpirtin, poetucë,  
t'u mbledhë vetë proletariati  
dy këmbët në një këpucë.

Vargun e kemi metalik,  
materje e gjallë ne jemi.

Le t'i shërbejmë çështjes së klasës,  
vargun plumb ta kemi.

Vargun ta kemi dhe filil,  
ta kemi bomb' e flamur,  
të ndizet bota me kolltukë  
dhe poetucë të majmur.

Kështu e deshe vargun ti,  
sa herë na porosite

që në filozofinë e pellgut  
poeti të mos mbytet.

Poezinë tënde dua pranë  
gjithmonë pranë ta ruaj.

Me lavde fryhen poetucët,  
porsi kacek dhe buaj.

Qytetërimin gjoja sjellin  
në vendin e Leninit.

O, tradhëtarë, q'helm si Trocki,  
pse Vollga s'ju përpin?

... Ne dimë kaq shumë të dashurojmë,  
po kaq dhe të urrejmë,  
ne dimë të shëmbim burokratin,  
punëtorin lart ta ngremë.

Ti shkrove vargun më të mirë  
për punëtorinë, Vollodja.

Kështu mësonte, si baba  
i urti, i miri Lenin,  
të shkruajmë vargje për punëtorin  
dhe elektrifikimin.

Lenini tokësori fliste  
për proletariatin,  
që diktaturën proletare  
të fortë, të rreptë ta mbanim,  
po, në Bashkimin Sovjetik,  
u shua, ra dhe iku.

Këtë diktaturë proletare  
    tradhëtia e griu e fiku.

Dhe poetucët duan vargje  
    me sentimente e lajka,  
s'duan heronj nga punëtoria  
    me gji të ndezur flakë,  
U miqësuan dhe me miset  
    në grataçuela e vila,  
janë afër shumë, ndonse janë larg,  
    me tok' e det me mila.

Po Marks i është me ne,  
    Lenini dhe Stalini.

O bolshevikë, bëni alarm  
    dhe tradhëtisë i bini!

Te Sheshi i Kuq çohu, Vollodja,  
    bëj të jehojë Tetori!

Te Sheshi i Kuq hidh vargjet bombë,  
    që në mesditë të plasin,  
që në tërmët të tundet stepa,  
    të huajt të pëlcasin  
toka nën këmbë ndezur të tundet,  
    të mungullojë baroti,  
që mos ta brejë erozioni  
    as shiu, as ngrica, as moti.

Të ngrihet si feniks i madh  
    e kuqe punëtoria.

Besimin lart, besimin lart  
    në ballë klasa punëtore,

si atëhere me Leninin,  
si atëhere me Stalinin  
në luftra e përvjetore.  
Tani duhet lëvizje, o popull!  
Pamfletë e mijra trakte,  
të tundet borgjezia  
në vila dhe pallate.  
Nëpër beteja, proletarë,  
gjëmoni zërin tuaj  
dhe fatin tuaj mirrni n'dorë  
bilardo mos ta luajnë.  
Seç m'u kujtua vetvetiu,  
që nga mitologjia e vjetër,  
se në një vend të largët shumë  
jetonte një mizor më emër.  
Na priste miq mizori vetë  
(e quanin Prokust),  
u shtronte dreka dhe bankete,  
po dhe këmbët u priste.  
Kishte një shtrat Prokust mizori,  
ku shtrinte kalimtarët:  
të gjatëve u priste këmbët  
të shkurtëve ua zgjaste.  
Por ai vetë ka qenë i shkurtër,  
të shkurtëra i kish gjymtyrët.  
Dhe erdhi vetë një ditë Tezeu  
ja zgjati, ja nderi mirë

Vetë tradhëtarët janë Prokustë  
në vendin sovjetik,  
që çojnë në shtratin për të matur  
vendet e vogla «mike».

Kështu bënë sot revisionistët  
me Çekosllovakinë.

Këtu duhet Tezeu-popull,  
marksistët-leninistët,  
që të vërsulen përmbi ta  
betejën që të nisin.

Ej, Majakovsk, trim o burrë,  
dhe invadorë u bënë,  
i vunë një turp atdheut tuaj,  
ata i mallkon çdo nënë.

Përpara popuj dhe më shpejt  
të shlytpur, proletarë!

Besimin lart, marksizmin lart,  
treni vigan përpara!

Në sytë e Gorkit det' i gjerë,  
ku fluturojnë zgalemat.

Se ja furtuna, vjen furtuna,  
vërtitet nëpër boshte,  
të fshijë nga dheu reaksionin  
dhe të pastrojë çdo qoshe.

Ata sulmuan si të çmendur,  
brenda një nate hodhën tanket  
dhe invadorë u bënë.

Partia ime, Majakovsk,  
mban lart flamujt e punës.

Në fryfshin erërat e marra,  
ne do t'i ngajjmë furtunës.

Partia ime, Majakovsk,  
mban lart Lenin-Stalinin  
dhe para popullit e pastër  
partia bën betimin.

Korrjet i kemi të begata,  
taracat plot traktorë,  
i gjallë në zemër na qendron  
kontrolli punëtor.

Partia ime, Majakovsk,  
ka miq në botë me mijra.

Në Tjen An Men, partia ime  
ka miq e shokë të shquar.

Lindjen e kuqe, që s'u trembet  
komploteve të huaja.

Atje revolucioni ndizet  
i madh në rrugë, në sheshe,  
mes dacibaove rrëzohen  
dhe mjergullat dhe reshjet.

Një miqësi (kaq afër) kemi.

Ku e gjetëm, kush na e fali?  
Vetë komunizmi dhe partia,  
që s'ka fuqi t'i ndali.

Tetori erdhi përsëri  
me erëra, brerime,  
kadenca e gjetheve që bien,  
të sjell ndërmend kujtime.

Tetori erdhi përsëri.  
Sa ftohtë që ndjen pranë bustit,  
o burrë i ndershëm, Majakovsk,  
që erërat përbuze!

Tetori erdhi përsëri  
në vendin tënd me shira.

Tradhëti e tmerëshme rrëzoi  
ndjenja, ura, dëshira.

Ej, Majakovsk,  
me zërin tënd të mbushur  
dil përsëri me poezinë  
në fushë pér t'u përlleshur.

NIKO KACALIDHA

## STUHI DRITE

(Poemë)

1

Erdhi koha  
që ti, klasë punëtore,  
në duar  
more frenat e historisë.  
Ndërgjegja e re e një populli të munduar –  
trungu i fitoreve,  
lulëzim stuhish.

Lufta klasore  
të zjen në çdo qelizë,  
dafina vetëtimash  
ta kurorëzuan ballin,  
në kyçë ende  
ke  
gjurmat e prangave të kapitalit.

Kollose janë mijra veprat e tua;  
rrënjet e çelikut

zgjaten thellësive,  
kollonat e sigurta t'oxhakëve,  
si duar  
afishet e tymnajave të bardha  
ngjitni qiejve.

Kolloso janë mijra veprat e tua.

Porse unë shtatin e tyre,  
madhësinë,  
gjithë lartësitë e pamata,  
ndërtimet,  
i kanë ato burimet  
në madhështinë  
e moralit tënd,  
që farkëtove,  
klasa ime!

Me ozonin e uzinave

u zure frymën

«perëndive»;  
nga flaka e furrave shkrirëse  
-behet ari, smeraldi.

Ti krismat e përlleshjeve të djeshme përtërive  
në çdo thirrje sirene,  
në çdo tingull metali.

4

Jo si soditës mes punëtorëve hedh çapet,  
barrën e mendimeve punëtore ngarkoj  
në çdo brazdë që çahet,  
në çdo linjë që zgjatet,  
N'çdo themeli që hapet  
dorën e tyre shikoj.

Kudo nga shkoj,  
eci mbi rrugën e re i gëzuar,  
si në një rrjedhë të pafund lumturie.  
Shkoj mbi mendimet e tyre,  
mbi duart  
që e ndërtuan.

Shkoj mbi ditët e tyre.

Ndjej:  
jam i lidhur me fije të padukëshme,  
jam i lidhur me fije intime,  
jam i lidhur me fije të kuqe,  
me fijet e idealeve,  
me ty, klasa ime,  
klasë e proletarëve.

Të përket ty çdo gjë imja,  
 të përkasin të gjitha:  
 gjaku im,  
 dashuria,  
 ëndërrimet rimore,  
 që kur, tok  
 me aromën e trëndafilave, thitha  
 vrullin e fabrikave  
 në mëngjezet punëtore;  
 që ahere kur nisa  
 tok me lodrat e thjeshta  
 të ngre mure të vogla  
 dhe pallate me rërë,  
 që kur hyra një ditë  
 midis shokëve në rrështa  
 dhe shtrëngova fort veglën  
 në pëllëmbën e gjerë.  
 Të përket ty gjithçka imja,  
 e bijve  
 dhe e nipërvë,  
 se mes plehrave të skamjes  
 s'do na lësh ti askurrë,  
 se na fale  
 më të madhen  
 liri të të shtypurve,

që mban emrin e rreptë,  
kuptimplotë  
diktaturë!  
... S'kam pse fjalë lajkatare  
nëpër dhëmbë të përtyp,  
porse them:  
shtatë jetë  
borxhli të jam sot,  
i braktis që të gjitha  
kur zë shkruaj për ty,  
vetëm ty...  
Veç tek ti  
me fanatizëm mbahem fort.

6

Më kujtohet:  
Njëherë,  
në çatinë e shtëpisë,  
muratorët  
u ngjitën  
të zënë pikat e shiut.  
Unë mendoja,  
ëndërroja:  
sikur  
një shkallë  
të kish,

që të ndreqnin pak dhe qiellin,  
të mos lagej njeriu.

Isha i vogël  
në botën pa gardhe të ëndërrave,  
porse ti  
ma skalite sot gjithçka në granit  
dhe në qiellin e kohës,  
përmes dallgës së erërave,  
shkallët e lumturisë  
i ngrite në zenith.

7

Dhe a s'ishe ti  
që më thirre:

«Bir, eja!»

dhe për mua si nënë hape gjinë?  
Erdha...

Në themelët e ditëve të reja,  
si gur numur një  
vura ideologjinë.

Ti komunizmin  
ma bëre të qartë  
jo si një diell simbolik që buzëqesh,

**por**

yll polar në shtegëtimin e gjatë,  
një minierë energjish,  
arsenal rrufesh.

**Ligji yt**

të papajtuar më brumosi  
me çdo ndryshk,  
ndohtësirë,  
vetkënaqje  
dhe çdo ves,

Fyt më fyt

me të vjetrën,  
me armiqtë e çdo mostre,  
i papërgjunjur do hedh hapin,  
do luftoj  
edhe do vdes.

8

**Si ta duroj**

(heuu!) meskinin gërdallë

«Ke shkollë?..

**Se në kazmë**

ha dynjanë,

o i shkretë!»

Kush apartamentin  
dhe karrigen tende vallë  
e nderto?  
Si ta duroj unë  
njerithin filistin  
që të mat kokë e këmbë  
me dy sy prej lejleku  
dhe pyet më në fund,  
Kur mëson mjeshterinë:  
«Po mirë,  
a del leku??..

9

Të bukura ditët tonë,  
të bukura!  
Në prehërin e pranverave,  
fëmijë të bukur lozin,  
fëmijë që asnjeherë s'do t'u shohin sytë  
skarlatinën e mjerimit  
dhe gëlbazën e tuberkulozit.  
Nëpër dyert e larta të kombinateve  
futen  
galeritë e minierave,  
pishat,  
peshqit,

pambuku.

Brenda nesh janë thellësitë  
dhe hapësirat e pafundme.

Nga përpjekjet  
e përflakura

lind në fund

fjala «bukur!»

Le të japin sot repartet

sa më tepër prodhime;  
më shumë shtylla,

bakër, krom,

tel

të nxjerrin uzinat.

Dhe lëndinat të rrëshqasin në tezgjahe,  
klasa ime!

Më shumë kazma e traktorë  
dhe, në fund,

limuzinat.

10

Të bukura ditët tonal!

Oqeane drite!

Shih,

asfaltet e lara

llamburijnë nga shkëlqimi,  
nëpër xhamat e dritareve

zbardhëllimi po ngjitet

si një valë mirazhesh  
që nga toka thellë lindin.  
Prozhektori i madh i diellit  
shkrepëtin sipër dallgëve,  
rrëzëllon hije e zjarrtë,  
që mbi ujra lëshon,  
ndërsa treni rrëshqet përmes fushës,  
binarëve,

si një brohoritje e gjatë

në horizont.

Era qesh  
edhe plepave u kreh krelat,  
sipër nesh  
harqet

e neonëve përkulen,  
kurse krahu lëvizës i vinçave mbi skela  
posi tytë kundërajrori

ngrihet, ulet  
ngrihet, ulet...

11

Përmbi prizmat e dritave,  
errësira zë thyhet,  
si një lumë shumëdegësh  
gjallëria lëviz,  
nata elektrifikon qiellin.  
Shikoni,

mbi krye  
hapet libri gjigant i astronomisë!  
Dhe mbi fashat e rrugëve,  
mbi asfaltet e ngjyer,  
kush më këmbë,  
në urban  
e dikush në bicikletë,  
po nxitojnë  
punëtorët  
që nga turni janë kthyer  
me një pushkë në krah  
drejt alarmeve...  
drejt!

## 12

Të bukura ditët tona,  
të mbushura  
me gëzime të sinqerta,  
dashuri njerëzore.  
Buzëqeshjet e vajzave me dëshirë të purpurt,  
Ti, klasë e re,  
që ndërton sot vetveten,  
që grushtin e kontrollit punëtor  
mijra tonsh  
ngre mbi barierat burokrate,  
mbi zgjebën,

mundesh

«sistemin diellor të rindërtosh!»

Ti,

që vështrimin mijra sysht

hedh mbi jetën

dhe me duart si darë

zë zgjidh nyjen e «treshes»,

për mehmurët e strukur n'atë «qoshen e qetë»  
je fshesa m'e tmerershme.

### 13

Po, ka burokratë

e jo vetëm në zyrë

me trupin e butë

mbi dosare gërmuqur,

po ka dhe të tillë,

që u zë gjaku zgjyrë

dhe atje

ku rrjedh hekuri

i pastër,

i skuqur,

veç ata janë të «aftë»,

u dalin mbanë

të gjitha punëve,

ndaj shpesh herë shohin «poshtë».

Nga shkallinat e postit

solemnisht

zënë e hapin

megafonin e buzëve,

që baticën

e mendimeve

të punëtorëve

të mposhtin.

Gojëmjaltë,

që buzëqeshja babaxhane s'u shqitet,

bëjnë shaka...

(Bile bëjnë në mëngjez gjimnastikë).

Në detyrë «shok tjetër s'kanë»,

të «pazëvendësueshëm» hiqen,  
edhe frazat

nëpër dhëmbë

i përtypin

si mastikë,

si të puthnin vetë shefin,

puthin buzët e receptorit,

dhe ndaj stufës me drumbushur

kthejnë kurrizin «reumatik»,

...Mbi tryezat

e koncepteve

burokrate,

klasë punëtore

të godasë grushti yt

posi çekiç pneumatik!

Sot,  
 me flakën e flamujve tē punës  
 ti ndez  
 fitilin e vijës vitale  
 tē masave,  
 që shkrumbon kalbësitë...  
 Porsi ujku,  
 ende  
 po përgjon' kapitalizmi, revizionizmi  
 prapa thikave,  
 maskave.

Nga armiqtë e nëndheshëm,  
 tē varrosurit e «gjallë»,  
 nga mikrobet që as plumbi s'mund t'i kapë,  
 s'mund t'i tresë;  
 përmbi trupin e popullit  
 ai prapë  
 do tē ringjallë  
 prapë tē zezën,  
 borgjezen,  
 vdekjeprursen shtresë.

Po ti, klasë e kuqe,  
 asnjëherë  
 s'do lejosh

të ringjallet  
polipi  
përbindësh  
shfrytëzimi.

Stuhi drite

do të mbetesh!  
Dhe për mua, në çdo moshë,  
klasa ime,  
do të mbetesh  
një fontanë frymëzimi.

15

Erdhi koha që kudo ndihet  
pesh' e veprës sate.

Dhe në hapat,  
dhe në fjalët,  
dhe në letër,  
në mendime  
toka jonë  
kumbon.

Pulsi i këngëve matet  
me ritmin tënd industrial,  
klasa ime.

Erdhi koha...  
Mes furtunave,

fatet e Shqipërisë  
ke farkëtuar,  
levat e fitoreve  
e sigurtë i lëviz,  
krahun e hekurt  
e shtrin  
horizonteve,  
pellëmbën e madhe  
u tok  
revolucioneve.  
Erdhi koha;  
në duar  
ti  
mban frenat e historisë!

### FOTAQ MALO

## NE JEMI BASHKË, BABA!

Ne ishim pesë veta: babai, unë, dy partizanë, dhe një oficer gjerman, rob, që do ta çonim në shtab. Na udhëhiqte babai, që i njihte shtigjet mirë. U nisëm në mëngjez, kur dita sapo kishte aguar. Ecnim nëpër shtigje e monopate. Ndalonim për t'u çlodhur ndanë ndonjë burimi a kroi. Burrat pinin cigare të dredhura. I zgjatnin qesen e duhanit robit gjerman, po ai thoshte: — Nein! — dhe bënte me shenjë se nuk pinte duhan. Ngriheshim të mpirë nga gjymtirët dhe ecnim të dembelosur një farë kohe, derisa nxeheshim. Kështu udhëtuam gjithë ditën. Në mbrëmje, babai na nxori në një lëndinë. Pamë pak më tutje një re tymi, që ngrihej mbi një çati prej xunkthesh. Ishte pranverë. E mbaj mend mirë si sot. Ishte nga ato pranverat e vona që vinë pas një dimri të ashpër. Dëbora zbardhte maleve dhe pranvera sapo u kish hedhur kurorat e para bajameve.

Shtëpia ishte stan i një bariu. Babai e kishte të njojur. Duhej të pushonim patjetër. Ishim të

Iodhur dhe gjumi po na kapiste qepallat. Ju afruam portës. Në oborr ishte një kasolle, nga e cila dëgjo-heshin tingëllima këmborësh.

— O Zenel! Zenel, ore-e! thirri babai. U dëgjua një e kërcitur lese nga kasollja e bagëtive.

— Kush thërret?! — dëgjuam një zë pas nesh. U kthyem nga vinte zëri. Ishte një mesoburrë, trupmadh. Mbante në njérën dorë një kusi me qu-mësht. Kokën ja mbulonte një qelepoçe myzeqare.

— Ti qenke, o Mete? — pyeti babanë.

— Unë i téri, o Zenel, siç më sheh.

— Mirë se erdhët.

— Ju zumë derën sonte, — tha me shaka Dalipi, njëri prej partizanëve.

— Të hapur e kam derën për miq unë, burazer, — ja priti bariu dhe bëri përpara për të na futur në dhomë.

U ulëm këmbëkryq pranë vatrës. Babai ja zgjidhi duart gjermanit dhe e la të rrinte midis nesh.

— C'e ke këtë korb, or Mete? — pyeti bariu du-ke treguar me shenjë nga gjermani.

— Lëre, Zenel, se i ka pendët të shtrenjta. Është flori ky... E kërkojnë atje lart... do ta shpiem... Këtu jemi të sigurtë, hë?

— Si në dorë të shqiptarit.

Bariu nxori qesen e duhanit. E la përpara dhe të gjithë me radhë drodhën nga një cigare. Ja shtruam një muhabeti vënçe. Gjermani rrinte si

mumje midis nesh dhe sytë i puliteshin për gjumë. Gjuha e ndezur e kandilit dridhej aty mbi oxhak. Bariu na shtroi për të ngrënë. Një çanak me kos taze, misërniqe të verdhë dhe djathë të njomë stanë. Kishim uri. Hanim në heshtje. Bariu më hodhi një vështrim të habitur dhe, sikur të më kishte parë atë çast, pyeti babanë.

— Po këtë birce q'e keni me vete, o Mete?

— Është im bir. M'u qep që kur dola në mal dhe tani s'më ndahet këmba këmbës. — Dhe i tregoi Zenelit si kishte dalë në mal bashkë me mua...

Babai kishte dy vjet që s'po i paguante të tretën beut. Ai e kishte kërcënuar sa herë, po babai i përgjigjej:

— Skam ç'të të jap, o bej, veç shpirtit.

Njëherë, beu erdhi kaluar me qehajanë. Nuk e pyeti babanë në kishte t'i jepte të tretën, po i rrëmbeu kaun, që mërzente nën hien e një rrapipara shtëpisë. Babai ju lut që mos t'ja merrte. Atëhere e kam parë babanë të qante si fëmijë, kur pa beun dhe qahajanë që kishin vënë përpara kaun. Dridhej nga inati. Vrapoi brenda në shtëpi, mori pushkën që e ruante nga koha e Fan Nolit. Dëgjova një të shtënë dhe pashë beun që u rrokullis nga maja e kalit. Qahajai ja dha vravit me të katra. Babai ndenji një çast pa lëvizur. U kthyte nga shtëpia. Nëna, me tim vëlla në dorë, kishte dalë e lebetitur në prak.

— Ika, grua, — i foli babai me një frymë, — ika  
në mal, sa s'është vonë. — Puthi vëllanë e vogël,  
nënën, pastaj mua. Vrapoi të hynte në pyll. Unë  
e ndoqa pas. Nëna më thirri, po s'e dëgjova. Vetëm  
kur hymë thellë në pyll babai më vuri re.

— Po ti këtu?

— Do vi me ty! — i thashë unë duke m'u marë  
goja, dhe qava me ngashërim. Që atëhere u bë-  
ra partizan. E ndiqja babanë nga pas kudo që  
shkonte...

Mbaruam së ngrëni. Uruam të zotin e shtëpisë.  
Dalipi ju lut pastaj të shtronte ç'kishte e të flnim.  
Gjermanit i shtroi veç, në këndin e djathtë të dho-  
mës. Ne na shtroi në anën tjetër. Mua më ra shorti  
të ruaja gjermanin. Pas një orë e gjysmë do të  
zgjoja Temen, partizanin tjetër, një djalë nga një-  
zet e shtatë vjeç, me një palë mustaqe të verdha  
si kashta. Ja lidhëm duart gjermanit dhe ramë të  
flnim. Unë ruaja, i ulur pranë tij, me revolverin  
e babait në dorë. Mendjen ma përshkonin lloj-lloj  
mendime. Kur erdhi koha, zgjova Temen.

U zgjuam herët. U përshëndoshëm me bariun  
dhe bëmë poshtë një shtegu. Trastën me ushqime,  
që na dha bariu, e mbante Dalipi. Babai thoshte  
se, po të ecnim mirë, mund të arrinim aty nga mbrë-  
mja në shtab. Koha ishte e mirë: mëngjez i freskët  
me këngë zogjsh. Tek-tuk dëgjoheshin tingëllima  
këmborësh dhe murmurimi i ndonjë përroi që ka-

lonte midis shkurresh. Ecnim shpejt, pa folur. Kur dielli u ngjit lart në kupë të qiellit, ndjemë të nxeh-të dhe lodhje. U ndalëm te një përrua. Hëngrëm nga një copë misérniqe me djathë, pimë ujë me etje. Ata ndezën nga një cigare.

- Pini ujë sa të ngopeni, se s'kemi më përpara.
- Të kishim ndonjë bodile, o Mete, — tha Temja.
- Ja që s'kemi... Ngrihem? — pyeti dhe urdhëroi babai.

Unë ngjesha pushkën në sup. Rripi i saj më priste dhe e kaloja sa nga një krah, në tjetrin. Bë-më një copë rrugë në heshtje. Befas babai u ndal. Një oshëtimë motorësh u dëgjua poshtë nesh. Hodhëm sytë. Aty pranë kalonte një rrugë maqinash. Një kolonë motoçikletash nxinte. U ulëm që të mos dukeshim dhe pritëm gjersa u larguan. Pastaj vazhduam rrugën dhe ecëm gjithë ditën.

\* \* \*

Ishim lodhur.

- Gjermani qendroi në vend. Babai iu afrua.
- Ecë! — i tha. — Ecë shpejt! — Ai e shikoi në sy.
  - Waser! — bërtiti.
  - Çfarë thotë ky? — pyeti babai duke u kthyer nga ne.

— Kush ja merr vesh gjuhën, — foli Dalipi. Gjermani ju afrua shumë babait, zgjati gishtin e madh drejt gojës dhe bërtiti:

— Wasser!

— S'ka wasser, — tha babai, duke e kuptuar ku e kishte hallin. — Edhe ne na u tha gurmazi për një pikë ujë, po ecë.

Mbas një ore u gjendëm para një përrroi me shtrat katër metra të gjerë. Ndaluanam pranë tij. Ujët rrëshqiste mbi gurët e lëmuar. Thellësia mund të ishte deri në brez. Temja u kthyte nga gjermani:

— Hidhu tani, waser deshe? — dhe i dha një të shtyrë. Gjermani i tmeruar u gjend në ujë dhe nga frika llapashiste duart. Mendonte se ishte thellë dhe lutej:

— Mein Gott! Mein Gott!<sup>1)</sup>

— Shiko pizevengu, — tha Temja, — nuk pi dot me grushte, po do gotë. — Gjermani e kuptoi se frika e tij ishte e kotë, kur i zunë këmbët dhe. — Zuri të pijë i etur me turinjtë të kredhur në ujë. Pimë dhe ne. Ndenjëm ca dhe vazhduam rrugën.

Dielli përfundonte trajktoren në perëndim. Për pak do të çikte majat e pemëve. Ecnim mbi një breg. Pak më tej, nën këmbët tonë, kalonte një hendek sa një boj njeriu i thellë. Dëgjuam fëshfëritje dhe një zë të fortë: — Halt! — Pamë një gjer-

---

1) Zoti im!

màn me automatik njëzet metra larg dhe disa koka fshehur kaçubeve. S'e mora dot me mend sa ishin. Temja i dha një të shtyrë gjermanit dhe sa hap e mbyll sytë u gjendëm në hendek. Një batare automatiku fluturoi mbi kokat tona. Gjermani zuri t'u bërtasë shokëve në gjuhën e tij. Dalipi e zuri nga gryka dhe i lidhi gojën.

— Pusho ti, qen bir qeni! — Gjermani zuri vend në fund të hendekut. Babai, Temja dhe Dalipi po qëllonin. Vërtisja pushkën në duar; mundohesha të luaja llozin. Isha vetëm katërmëdhjetë vjeç. Nuk dija mirë ta lëvizja. Doja ta mbështetja diku tytën. Po ku? Në dhé? Punë që s'bëhej! Po më në fund e gjeta atë vend. U ngjita pak mbi faqen e hendekut, aq sa të hante vështrimi i pushkës. Pashë një kokë midis kaçubeve dhe një grykë automatiku, që villte zjarr. Shënova dhe shtypa këmbëzën. Një kapelle fluturoi nga koka. — Një gisht më poshtë! — thashë me vete dhe nisa të shënoj përsëri. Babai dhe dy partizanët e tjerë ishin shtrirë mbi faqen e hendekut dhe shtinin. Unë isha pranë gjermanit dhe ruaja çdo lëvizje të tij. Ndonjëherë shtija. Dëgjova Dalipin që u ankua. Ai foli me zë të ulët, sikur s'donte ta dëgjonin ata përtej:

- M'u mbaruan fishekët, Mete.
- Sa të kenë mabetur? — pyeti babai.
- Edhë një batare, — tha ai.
- Dëgjo... ti je nga këto anë, i njeh mirë shti-

gjet. Ndihamo shokët të tërhiqen! Duhet ta shpiem gjallë robin, se është me vlerë. — Temja u step.

— Po ti? — tha me habi.

— Unë do t'i mbaj një copë herë gjersa të largofhi, pastaj, po shpëtova nga përleshja, do të tërhiqem e do t'ju arrij.

Po errësohej. Yje të vetmuara shkëlqenin në qiel. Mezi dallonim njëri tjetrin. Të shtënati vazhdonin: U zvarita te babai.

— Do rri dhe unë me ty, — i thashë.

— Shko me ta — më tha me hakërrim. Këtë herë nuk qava. U binda në heshtje. Temja kapi nga zverku gjermanin, që nuk ndihej i gjallë, e shkundi nja dy herë dhe u nis vetë përpara. Ne i shkuam pas duke u përkulur. Ecnim lehtë për të mos bërë zhurmë. Të shtënati dëgjoheshin paprerë. Ne largo-heshim dhe ato bëheshin më të mytura, të shurdhëra. Pastaj s'dëgjuam gjë...

Mbas dy orësh arritëm në vendin ku ishte shtabi. Roja na bërtiti të ndalonim posa na pa hiet. Temja i këputi një batare të sharash nga ato të labërisë dhe ai s'e bëri të gjatë. E dorëzuam gjermanin. E kaluam natën jashtë, pranë një zjarri, që e ndezëm aty për aty. Nuk flisnim. Goja sikur na ishte myllur. Temja dhe Dalipi pinin cigare. Unë mbaja pushkën, i fshija tytën dhe llozin me pëllë-

mbë. Temja më hodhi një vështrim dhe zuri të qeshë.

— Po ti ç'pate me gjermanin që desh e shkalllo-ve? — pyeti me shaka.

— Doja të luaja llozin duke mbështetur tytën në prapanicën e tij, — fola unë pa qejf.

— Si?! — S'i ktheva përgjegje dhe ai s'më foli më. Mendoja babanë. A ishte gjallë? Ç'kishte pësuar? A kishte menduar të shpëtonte? Po sikur të ishte i plagosur dhe të kishte nevojë për ndihmë? Ç'pyetje nuk më vinin në kokë! Dalipi u mundua të na hiqte mendjen andej, po unë isha pa qejf.

— Për Meten mendon? — pyeti Temja dhe më zuri flokët me dorë. — S'e gjen gjë atë... E njoh unë. Ai do t'u shpëtonte ditën e jo natën.

— Ndal! Kush lëviz atje? — bërtiti roja.

— Ç'është, more shok? — pyeti Dalipi rojen.

— Ndal! — bërtiti ai prapë.

Ne u ngritëm në këmbë. Pamë një hije që zvartej. E njoha... — Babai! — thirra me gjëzim dhe vrapova drejt tij...

U ulëm pranë zjarrit. Në gjoks i kuqëlonët një njollë gjaku.

— Ç'e ke atë nishan, Mete? — e pyeti Temja.

— Më plagosën kur u tërroqa, — tha babai.

Dalipi ja lidhi plagën me një copë nga këmisha e tij.

Babai mbështeti kokën në prehrin tim. Dre-miste. M'u duk se e zuri gjumi, po befas tha:

— Tani do të jemi bashkë, bir!

— Po... jemi bashkë, baba, — mezi shqiptova me gjysmë zëri dhe ktheva kokën nga errësira që të mos më shikonin sytë të tjerët.

## HAPAT NË BRUGËN E KALLDREMTË

— Nuk mund të të urrej. Më duket qesharake të të urrej.

— Duhet. Atëhere s'kemi për ta luajtur kurre këtë skenë.

— Ej... Eli... Guri. Gati për të xhiruar edhe njëherë skenën në qeli, — thirri regjizori.

Ata u drejtuan për në atelie.

— Dëgjo, Eli... Përfytyro sikur unë të kam braktisur dhe shkoj me një femër tjetër.

— Mos, Guri, atëhere s'do kisha guxim të të shikoja në sy. Jo, jo, trembem ta mendoj këtë.

— Atëhere...

— Çfarë?

— Duhet të më urresh. Në ekran duhet ta ndjejnë të gjithë se unë duhem urryer. Unë s'jam Guri gjatë xhirimit, po oficeri gjerman. Ti je heroina. Duhet ta ndjejnë të gjithë këtë.

— Do të mundohem...

Atelieja ishte ndriçuar nga prozhektorët. Kamerat përgjonin një skenë qelie. Drita u zbeh. Gjysmë-errësirë qelie që të zë fryshtë.

— Gati... — thërriste regjizori. — Edhe njëherë nga fillimi. Kujdes, Eli. Në këtë skenë duhet të shkëputesh nga realiteti. Ke përpara një oficer gjerman... Dëgjo... lidhe me ndonjë kujtim që të është ngulitur nga lufta. Atëhere ke qenë fëmijë, po diçka do të kesh dëgjuar. Jetoje pak atë kohë dhe kujdes...

Eli, me flokë të shpupurishur, të shpërndarë anëve të fytyrës, me disa shenja plagësh, me faqe të mavijosura, me sy të guximshëm. Gjysmëerrësirë. Ndriçohej vetëm trupi i saj, i mbështetur, i mble-dhur në këndin e qelisë. Operatori drejtonte kamerën drejt saj. Hyn Guri — oficer gjerman. Endet lart e poshtë qelisë, duke i hedhur hera-herës ndonjë vështrim hetonjës.

— Ju jeni e re... e bukur... gjynah të vdisni... — tha oficeri gjerman. Ajo e vështronte në sy. Kryqi i thyer në mëngët e xhaketës. Kryqi i thyer. E kishte parë që fëmijë. Atëhere kur i kishin marrë babanë.

(«Erdhënatë. Unë flija me nënën. Isha e vogël. Tani jam rritur. Erdhënatë dhe e morën. Unë lebetitesha duke parë ato fytyra të egra. Kishin kryqe të thyer në mëngë»).

— Nuk doni të flisni... Do t'ju lemë të lirë. Vëtëm pak gjëra na tregoni.

(«Nënës i dhanë një të shtyrë dhe e përplasën te dera. Unë u hodha mbi trupin e nënës duke qarë. Babanë e muarën. Që atëhere nuk e kam parë më»).

— Trego shokët e grupit tënd!

Sytë e tij e vështronin hetonjës, nënqeshës, përbuzës.

(«Guri është ky?»).

— Folë... — ulëriti zëri i oficerit gjerman.

Ajo e vështronte e shtangur.

(«Guri është ky? S'është e vërtetë. Guri është i mirë, s'është si ky. Ne kurrë s'mund të bëhemë si ky. Guri është i dashur»).

«Shiko, Eli... Shiko detin. Kaltërsi, pafundësi. Edhe ne jemi një copë deti: ne të dy — ti dhe unë.

Ai më përfshiu në krahë dhe më dha një të puthur»).

— Fooolë! — ulëriti përsëri zëri i oficerit gjerman.

«Ah Guri, unë s'të përfytyroj kurrë kështu!»  
Ai qeshi, edhe ajo qeshi...

— Keq, shumë keq, — thirri regjizori. — Nuk punohet kështu. Po humbasim kohën kot.

Pranë bufesë, jashtë studios, në pushim, Guri po i thoshte regjizorit:

— Ke të drejtë të zemërohesh, po duhet të kuptosh se ç'po ndodh në shpirtin e saj. Ajo është e re, për herë të parë luan në film. Pastaj marrëdhëniet tona. Ti e ke kuptuar.

\* \* \*

Asaj i thanë të luante në një film. Ajo në një film? Po, po, në rolin e një heroine. Ajo kishte ngruar.

— Jam punëtore... Shkollën e mesme e vazhdoj natën.

— S'ka gjë... jeni e përshtatshme për rolin tonë.

Kështu e muarën të luante në një film. Në filim e pati shumë të vështirë. Regjizorit ju desh të punonte shumë me të. Po pastaj ajo u dha me gjithë shpirt pas rolit të saj. Punuan për një kohë të gjatë në një nga qytetet e jugut, pastaj u kthyen në kinostudio të xhironin disa skena në atelie. U njoh me Gurin. Jo vetëm u njoh...

Ndodhi atë natë kur po ktheheteshin në hotel pas xhirimit të shpërndarjes së trakteve. Ecnin vetëm në një rrugë të errët me kalldrëm. Ai ishte me uniformën e oficerit gjerman. Ai i kishte shtrënguar dorën. Ajo s'e kishte kundërshtuar. Ecnin ashtu të zënë dorë për dore, pa folur fare. Ajo çuditej tek e cte me atë djalë që mbante uniformën e oficerit gjerman. Ju kujtua dita kur dëgjoi për herë të parë në megafonin e qytetit zërin e spikerit:

— Shokë qytetarë... Nëqoftëse shihni rrugëve të qytetit njerëz me uniformë gjermane, mos i merrni si të vërtetë. Janë artistët e kinostudios që luajnë një film artistik.

Atëhere kishte qeshur.

Edhe tani po qeshte tek ecte dorë për dore më atë djalë që mbante uniformën e oficerit gjerman.

— Hitler kaputt! — i thoshte duke qeshur.

— Pusho komuniste e dreqit. Farë e keqe.

Qeshnin të dy.

Kështu e kujtonte ajo atë natë tek ecnin rrugicës me kalldrëm. Ishte nata e parë e dashurisë së tyre.

Sa i mirë ishte ai.

«E dëgjoja gjithmonë netve ecejaken e tyre në rrugicën tonë me kalldrëm. Ç'hana të hekurt! S'më linin të flija tërë natën. Shtrëngohesha fort pas gjoksit të ngrohtë të nënës e prapë nuk mund të flija. Që kur na morën babanë, hapat bëheshin gjithmonë më të frikshëm e të padurueshëm. Më pëlqente kur gjëmonte qielli dhe binte shi. Hapat e tyre sikur treteshin me bubullimat dhe këngën e shiut. Atëhere mund të flnim pak. Na qëllonte shpesh të ngriheshim natën të tromaksura nga të shtëna të largëta dhe të afërtë pushkësh.

«— Shokë qytetarë! Nëqoftëse në rrugët e qytetit shihni njerëz me uniformë gjermane, mos i merrni për të vërtetë... Janë...»

Duhet ta luaj heroinën. Kam jetuar me heroinat

nëpër faqet e librave dhe të tregimeve. Tani duhet të jetoj nën vështrimin e kamerës. Guri është i mirë. Po e lodh shumë në skenën e qelisë. Edhe regjizori po humbet durimin»).

— Eli, gati për xhirim!

(«Tani duhet të përbledh veten. Le të kujtoj hapat e hekurt që më linin pa gjumë në fëmini... banchanë...»)

— Erdha, regjizor.

— Kush e drejton grupin tuaj në qytet.

— !..

— Folë! — Një e goditur me pëllëmbë. Ajo u përplas për toke. U ngrit me mundim dhe pa drejt në fytyrë sytë e egërsuar të oficerit gjerman.

— Fooolë!

— Po, do të flas, — tha ajo e vendosur, duke u ngritur me guxim nga vendi.

— Kush e drejton grupin tuaj në qytet?

— Partia Komuniste Shqiptare!

— Farë e keqe. Farë komunistësh. Do ta shkulim nga rrënjet këtë farë. Deutschland über alles! — Një e goditur me kurriz të dorës nën mjekër. Ajo u plas në dyshemenë me pllaka, të mbuluar me mbeturina kashte. Fshikullima kamxhiku. Ngërdheshje në fytyrën e oficerit gjerman.

Ajo u ngrit e dërmuar, po me një forcë të madhe shpirtërore. Ai nuk e kishte parë ndonjëherë me ata sy kaq të zmadhuar, me ata sy që flisnin aq shumë.

— Besoj se e kuptove. Ti je vajzë e zgjuar, e bukur! Trego kush e udhëheq grupin tuaj?

— Ata janë kudo, kudo. Unë eurrej atë rrobë që mban në trup. Unë tëurrej ty. (Unë hapat e hekurt mbi rrugën me kalldrëm. Ne luftuam dhe fituam. Gjithmonë do ta mbajmë të shenjtë kujtimin e heronjve. Kurrë s'do të harrojmë këtë rrobë që na vodhi dashuritë tonë, jetën tonë, që i bënte nënrat të qajnë dhe fëmijët të lebetiteshin.) Unë tëurrej. Ata janë kudo, maleve, rrugicave të qytetit tonë. Ata i udhëheq Partia Komuniste Shqiptare. Kurse ti je i urryer, ti duhesh pështyrë në fyttyrë. Afrohu.

— Afrohu të them, o kërmë.

— ...

— Më afër akoma...

— !

— Afrohu... Ptu!

— Bravo, Eli, mbaroi! — thirri regjizori i entuziazmuar.

### SHEFQET TIGANI

## BUZËQESHJE

Dielli po zhdukej diku pas kurrizit të Trifonit. Muzgu filloi të binte. Një ngjyrë e ëmbël trëndafili kish rënë mbi tokë.

Fshatari po ecte në mes të asaj rrugice të ngushtë që e shpinte në shtëpi. Bari ish bërë pér t'ja vënë kosën pér të dytën herë. Një erë e këndëshme vinte nga fusha, ku të grunjtat kishin marrë ngjyrë ari. Ai ecte dhe mendja pa dashur i shkonte te çupa. Ajo tani ish rritur dhe prej saj po i vinin telashet.

Dikush nga bashkëfshatarët i kishte thënë:

- More Trifon! S'e ke mirë atë çupën.
- Pse, ç'ka ngjarë? — ja pat kthyer Trifoni.
- Kam marrë vesh sikur ka kërkuar të shkojë në qytet pér një kurs.
- Pér çfarë??!
- Pér një kurs.
- Kush ta tha këtë?
- Ku ta di unë, kështu dëgjova. Kanë dalë dhe

vajza të tjera vulnetare. Ja për shembull çupa e Nikos...

— Jo, more jo, s'e lë unë të më ikë çupa — e ndërpreu Trifoni. — Dëgjove? Të tjerët të bëjnë q'të duan.

Dhe Trifoni ishte larguar i nevrikosur. T'ja bënte çupa këtë?! Çupa e vetme, së cilës ai i kish gjetur edhe burrë për ta martuar. Akoma nuk i kish foluar asaj për këtë. Por me lajmësit kish biseduar, e ajo punë kish marrë udhë. Por ja që vajza po e tur-përonte. Vërtet e kish të mirë. Të gjithë e lavdëronin, po tani ajo donte t'i ikte.

Pa u futur akoma në pragun e shtëpisë, thirri:

— Ku je, moj Vasilikë?

Aty u duk e shoqja që rrinte si e ngrirë. Ai e shikoi me inat.

— Ku është Vasilika?

— Më duket se ka një mbledhje.

— Mbledhje??!

— Po. Pse?

— Hej, dreq! Ç'na polli me këtë vajzë. Po ti, moj, pse e le?

— Çfarë t'i bëja? Erdhën e morën shoqet.

Ai s'foli. Vajti dhe u ul në vatër, mbështeti kokën në bryl dhe i tha së shoqes:

— Nuk e sheh që u err? Ndize atë të shkretë kandil!

— Ja tani do ta ndez.

— E po hë de — shfryu Trifoni nga që s'kish tjetër njeri kujt t'ja nxirrte atë duf që i qe mble-dhur në kraharor.

E shoqja ndezi kandilin dhe ai nxori kutinë e duhanit, i ra nja dy herë me gishtrinj, pastaj nisi të dredhë një cigare, por duart i dridheshin e filloi të flasë me vete.

«More, po i ka marrë koka erë kësaj çupës si-me. Ç'dreqin ka xhanëm? Në vend që të mblidhet në shtëpi se i ka ardhur koha për t'u martuar, shkon nëpër mbledhje. Dhe për çfarë?! Të vejë në qytet për kurs.»

Drita e zbetë e kandilit që i binte në fytyrë, bashkë me vetullat e trasha dhe të ngrysura e tre-gonte më të mplakur nga ç'ishte. Ashtu i rënë në mendime, dëgjoi të hapej dera e të hynte e bija.

— Mirëmbërëma, baba! — tha ajo me buzë në gaz, por buzëqeshja ju zhduk përnjëherësh sepse i ati e priti vrazhdë:

— Nga ishe?

— Kishim mbledhje...

— Mjaft me ato mbledhje!

— Pse? Do të shkoj në qytet në një kurs për elektriçiste.

Trifoni ngriti vetullat si i çuditur. U zbeh në fytyrë dhe u vrejt ashtu siç bënte ngaherë kur nxehet dhe gishtrinjtë e dorës ju drodhën, sa që i ra cigarja.

Mollëzat e faqeve ju frynë dhe mjekra filloj t'i dridhej.

— Elektriçiste?

— Po, baba; në kurs do të kem edhe shoqe të tjera.

Ai thithët cigaren fort dhe pasi u mendua pak e ktheu me të butë:

— Dëgjo, moj bijë! Ti e ke një mjeshtëri. Je kooperativiste.

— Por unë dua t'i shërbej më mirë kooperativës! — tha Vasilika.

— E po dëgjo këtu de! — shfryu i jati. — Unë të kam gjetur nji rast të mirë dhe do të të martoj.

— Jo, baba unë do të shkoj për elektriçiste. Sa për martesë, unë as nuk e njoh, kështu s'ka ç'më duhet ai që mendon ti.

— Moj, po e merr vesh ti se po më turpëron?

— S'kam bërë ndonjë turp deri më sot.

— Thyej qafën! — thirri Trifoni i nevrikosur.

Kaluan disa kohë. Vasilika shkoi në kurs, me gjithse i jati s'kish dashur. Atje kishin vajtur shokë e shoqe nga shumë krahina.

Vasilika në fillim e ndjente veten ngushtë. Nuk ish mësuar të largohej ndonjëherë nga fshati. Pastaj i dukej sikur nuk do të mësonte kurrë të vendoste ato tela. Megjithatë vullneti nuk i mungonte. Në zemrën e saj hynë njerëz të rinj, shokët e shoqet e kursit, që ndihmonin njeri tjetrin. Por më shumë

ju gjet pranë dhe jo vetëm kaq, një djalë me ballë të gjerë, me sy bojë qielli të shndritshëm. Ai ishte nga natyra i qeshur dhe gjithmonë optimist. Agim e quanin. Kur kallëzonte diçka, të gjithë i mblidheshin rrötull dhe e dëgjonin me vëmëndje. Ishte prej një fshati pranë me atë të Vasilikës dhe ai shpesh i shpjegonte asaj mësimet e elektriçitetit. Ajo dëgjonte e pastaj diskutonin. Dhe ahore ajo e ndjente veten të lumtur. Nuk e dintë, por diçka i kish lindur në shpirt. Kur mësonte e punonte me shokun e saj, Agimin, diçka ndjente për të, sepse ai ish i thjeshtë e i sinqertë. Fytyra e saj shprehte kënaqësi, gëzim.

Edhe Agimit i pëlqente të rrinte me Vasilikën. Ai nguronte t'ja shprehte asaj hapur këtë. I dukej sikur do të ndodhej para ndonjë detyre të vështirë. Por një ditë mori guxim dhe ja çfaqi hapur dashurinë. Në fillim zëri i tij ish i mbytur e ai druhej, pastaj bisedimi u bë më i thjeshtë, më i natyrshëm. Ai nuk e trazonte më jakën e këmishës si më parë, por fliste rrjedhshëm dhe qartë.

Kaluan disa ditë. Dikush i tha Vasilikës se e kërkonin te porta e konviktit. Kur doli te porta, përpara saj ish një burrë rrëth të dyzetave, që po i buzëqeshte. Ai ju afrua Vasilikës dhe i tha:

- Si je, Vasilikë?
- Mirë, faleminderit! Po ju kush jeni?
- Vasilikë, unë jam i fejuari yt, besoj se të ka folur babai për mua.

— Si? Kush jeni ju? — Vasilika u vrejt në fytërë. Unë s'ju njoh.

Burri u ngrys dhe tha duke e përbajtur veten:

— Babai yt më ka dhënë fjalën dhe unë erdha që të bisedojmë bashkë.

— Babai nuk më ka pyetur mua.

— Nuk ka gjë, Vasilikë.

— Më falni, por unë nuk jam më e vogël. Do ta vendos vetë fatin tim. Ju nuk jeni pér mua. Tani më falni, më duhet të shkoj.

Dhe Vasilika iku duke e lënë burrin me gojë hapur.

Pranvera erdhi shpejt në fshat. Nëpër rrugët e fshatit rridhnin rrëke uji të rrëmbyeshme duke shkumbëzuar rrëzë gurëve; nëpër pellgjet e mbushura plot me ujë pasqyrohej qielli i kaltër. Aty këtu nëpër lirishtet, fluturonin zogj që ciceronin të gjëzuar.

Në pranverë, Vasilika u kthye në fshat. I jati e priti ftohtë. Bile me një farë mosbesimi që e bija të ish bërë elektriciste, kurse e éma e përqafoi. Të nesërmen në mëngjez ajo filloj nga puna me shokët e shoqet e tjera.

Shpesh vinte dhe Agimi.

Dielli shkiste ngadalë përmes qiellit të kaltër. Malet ishin ndezur flakë dhe tërë fusha shkëlgente sa të merrte sytë. Frynte një fllad i ngrohtë. Vasilika befas duke e vënë buzën në gaz e përfshiu me

vështrimin e saj gjithë fushën që shtrihej përpara  
dhe i dukej sikur e shikonte për herë të parë. Sytë  
e saj të mëdhenj s'ngopeshin duke parë atë fushë  
ku që e vogël e dinte pëllëmbë për pëllëmbë. Pra-  
në kalonte lumi. Shpesh kish bredhur gjatë bregut,  
shpesh ish ulur buzë tij e shikonte peshqit. Atje  
ish larë kur kish qenë e vogël. Atëhere zhytej si  
bretkocat. E tani ish rritur. Edhe lumi ish bërë më  
i madh, po tani atij po i vihej fre. Ish ngritur diga.

— E moj romantike, a do të fillojmë? — e përmëndi Agimi Vasilikën.

— Agim! Ç'do të thotë babai kur ta marrë vesh?

— Do t'ja mbushim mendjen.

— Të them të drejtën do ta kem vështirë.

— Mos u bëj merak, Vasilika! Të vijë një hë-  
rë drita. Do ta rregullojmë dhe atë punë.

Vasilika kish veshur pantallona. Ajo ju afrua  
një shtyllë që kish vendosur rinia e fshatit dhe fi-  
lloi të ngjitej me anën e këmbalecave. Bënte lëviz-  
je të shkathta, të shpejta si një dallëndyshe që flu-  
turon. Në brez kishte lidhur rrypin e sigurimit.  
Tashmë ish mësuar ajo me këtë punë.

Për disa ditë me radhë elektriçistët brodhën  
udhëve, ndaluan, ju ngjitën shtyllave dhe vendosën  
tela. Pastaj ecën prapë, gjersa arritën te fundi i fsha-  
tit, te shtylla e fundit. Punonin me zell dhe ishin të  
empcionuar. Ditët e fundit punuan shumë që çdo  
gjë të ishte gati.

Dhe çasti i gëzuar erdhi. Yjet u venitën dhe ja lanë vendin agimit të purpurt. Fshati kish marrë një pamje feste. Fijet e korentit përshkonin gjithë fshatin dhe shtyllat e përfshira nga rrezet e diellit që digjte saç, lëshonin hije mbi tokë.

Vasilika u ngrit që në mëngjes herët. Fytyra e saj e nxirë nga dielli lulëzonte. Ajo do të bënte stakimin e parë e pastaj do të vinte drita në shtëpi-të e gjithë fshatrave përreth, që bënин pjesë në kooperativën e bashkuar. Kur erdhi çasti, Vasilika ishte e emocionuar. Njerëzit që më parë këndonin e thërrisin, pushuan. Të gjithë e kuptuan se ajo që pritej prej kohësh, do të ngjiste. Vasilika drejtoi dorën te leva dhe e vendosur e lëvizi atë. Aty afër ndriçuan dritat. Nga fshati buçiten britma hareje, thirrje, filloi muzika.

Sytë e zinj të Vasilikës shndrisnin nga gëzimi i papërmbajtur. Kishte dhe ajo pjesën e saj në gëzimin e fshatarëve. Afër saj u ul kryetari i kooperativës që mbante për krahu të jatin. Ai mbante kokën lart dhe një buzëqeshje e lehtë i kish shpërthyer në fytyrën.

— Jot bijë, punoi pa u lodhur për dritat, Trifon.

— Faleminderit, — tha Trifoni.

Vasilika ju hodh të jatit në qafë. Ai e shtrëngoi fort në gjoks. Fshati ushtonte nga këngët.

## BARIU

Nga malet filluan të zbresin retë. Ato shkuan drejt perëndimit dhe pastaj u shkrinë nën koridoret e shelgjeve ku kullonte bagëtia duke lëshuar blegërimë gazmore.

Pas pak filloj të fryjë një erë e fortë dhe qelli u bë pus. Dukej se do të kristë ndonjë rrebesch i madh. Dhe me të vërtetë, një vesë e hollë shiu nisi të bjerë, pastaj ai ja dha me vërtik.

Bariu i ri, një djalë me trup të hedhur, me culufe të rëna mbi ballë dhe me faqet buçko, shqetësua. Thithi dhe një herë fort cigaren dhe pastaj e flaku tej në barin e buisur e të lagur.

Librin dhe fyellin që mbante në dorë, i futi thellë në gji.

Çurka uji i rrodhën nëpër mollëzat e faqeve dhe nga qafa në kurriz. Ai hodhi gunën krahëve dhe e ngjeshi kapuçin në kokë.

Hodhi vështrimin rrotull. Nga malet po zbrisnin

rrëkera të mëdha mbi luadhin e blertë. Përroi që kalonte aty afër, sa të hapësh e të mbyllësh sytë, u mbush.

«U tèrbua pérroi. Duhet ta drejtoj shpejt bagëtinë në ndonjë shteg. Nuk i zihet besë kësaj kohe» — tha me vete.

Qeni Balo qëndronte pa lëvizur. Bagëtia ish turrur drejt bariut dhe e kish rrethuar. Edhe ata qingjat e vegjël, që më parë hidheshin e kërcenin si fëmijët e vegjël kur dalin fushave, qenë struktur pas deleve që ruanin pamjen e tyre të rëndë. Leshi i tyre që më parë ndriste sikur të ish lyer me vaj, ish mbledhur topa-topa.

Shiu u bë më i fortë. Nuk shihje asnijë çap më tej.

Bariu i ngau dhentë pérpara, eci nëpër lajthiste ku të rrihte suferina nga të gjitha anët.

Ai mendonte: «Ta marrë djalli, ta marrë! Sot do të kisha bërë mirë ta mbaja bagëtinë afër vathës. Kush ja di teket kësaj kohe? Në mëngjes ajo ishte qelq».

Dhe i kujtohej kur ish ngritur, apo kish dalë ylli i bariut dhë e kish ngarë bagëtinë pérpara në kullotë. Këtej pérroit kullota ish më e mirë se matanë. Dhe kryetari i kooperativës i kish thënë: «Çoje bagëtinë në kullota të mira. Bari është melhem për to, o Lipe! Pastaj ti e di kjo kope është një pjesë

e asaj që kooperativa jonë do t'ua dhurojë atyre maloreve. Duhet t'ua çojmë të majme atyre. Le që ti e di vetë këtë punë».

Apo s'vinte dhe një freski nga pérroi dhe shelgjet që të kënaqte shpirtin. Sa të gjëzuar dukeshin ata qingjat e vegjël në mëngjes! Dhe ai vetë, ashtu ulur rrëzë një peme, duke i rënë një melodie gazzmore me fyellin e tij, kënaqej kur shikonte këtë tabllo të bukur e kujtonte vargjet e Naimit:

*Nëpër shesh' e nér bregore janë pérhapur shqerrat e kecërët nëpër rripat dhe në gjethet e në ferrat. Sa me gaz e me vrap bredhin edhe lozin shok me shok, aty pérhapan me nxit, aty mblidhen prapë tok.*

Prandaj kish zbritur ai këtyre anëve. Por ja që koha ish prishur.

Muskujt e fytyrës filluan t'i lëvrinin. Vetëtintë dhe pemët sikur lëviznin me forcë nga era që fshikullinte. Nata dalngadalë filloi të bjerë. Gjithëçka u errësua.

Lipja me kërrabën në dorë, mundohej ta largonte bagëtinë nga bregu i pérroit. E dinte ai se ato s'pérmbaheshin. Nuk duhej që ndonjëra të merrte arratinë andej se pastaj hajde t'i mbaje të tjerat. Mund të hidheshin të gjitha njëra pas tjetrës dhe ai të mbetej me kërrabë në dorë!

Ish pasuria e popullit ajo, një pjesë e bagëtisë së kooperativës dhe aq më shumë nga ajo që do t'u dhurohej zonave malore. Kujtonte fjalët e kryetarit, ai. Edhe fshatarët. Ç'do të thoshin vallë ata që t'i humbte qoftë edhe një dele e vetme? Ata kishin pasur besim tek ai. Kot nuk i kishin vënë dhe një fletë-rrufe ku e lavdëronin se e mbante bagëtinë mirë. Delet e kopesë së tij kishin pjellë të gjitha dhe jepnin qumësht me bollëk. Jo! Ai kish besim se nuk do të turpërohej. Megjithëse i ri, ja kish marrë dorën punës së bariut. Ishte nga ata që ja kishte mësuar huqet bagëtisë qysh i vogël. Asnjëherë nuk i qe ku-qur faqja. Dhe s'donte t'i skuqej as këtë radhë.

Trupi i tij ndjente freskinë e tokës. Bari fëshfërinte nën këmbët e tij. Era përzier me shiun ja rrih-te fytyrën e pjekur nga dielli. Telat e elektrikut që s'kishin shumë kohë që ishin vënë nëpër shtylla, s'dukeshin fare. Vetëm kur shkrepëtinte, ai i dallonte ata. Pastaj vështrimi i tij rrëshqiste te shelgjet, bari i njomë dhe përroi. Ai rridhët me rrëmbim dhe kish filluar të gërryente brigjet e tija.

«Va s'gjen, se përroi po arrin buzët» — mendoi Lipja. — Duhet të drejtohem te ura e vogël. Po ec e gjeje në këtë pus. Mos e kam lënë pas! Po sikur të jetë vidhisur?!» Këto mendonte Lipja duke ndjellë pas vetes tufën. I dukej se për herë të parë ndodhej në një udhë pa krye. Edhe një herë e kish ndjerë veten ngushtë. Kish qenë vullnetar në aksion

atëhere. Punonte në ndërtimin e një ure të heku-rudhës bashkë me shokë të tjerë.

Dhe atë natë kish rënë shumë shi dhe lumi që kalonte nën urë ish bërë i rrëmbyer. Ata duhet të vinish patjetër beton në këmbën e urës. Jepnin e merrnin, por valët e rrëmbyera të lumit nuk i linin. Ai me shokët e tij kish luftuar shumë atë natë. Ishin bërë qull nga koka e deri në këmbë dhe më në fund kishin dalë fitimtarë.

«Po atëhere isha me shokë — mendoi. — Po tani si t'ja bëj, që jam vetëm?»

Megjithatë i jepte vetes guxim.

Shiu vazhdonte të binte. Bënte ftohtë. Bagëtia dridhej. Sidomos ata qingjat e vegjël dhe akoma të pamësuar. I shikonte Lipja dhe i vinte keq për ta. Ju duk sikur kishte përpara djalin e tij të vogël Nasin, që aq shumë e donte. Në të vërtetë për të ai ish i qetë. Nasin e kish në shtëpi ndoshta duke parë ndonjë revistë apo duke luajtur me lodra, në dhomën e ngrohtë.

Po qingjat e vegjël? Ata mundoheshin të ngro-heshin nën trupin e nënave të tyre dhe s'arrinin. Dridheshin sikur t'i kiske vënë në korent.

Lipja ju afrua atyre dhe filloi t'i përkëdhelë si për t'u dhënë zemër.

Por qingjat e vegjël vazhdonin të dridheshin. Hodhi përsëri vështrimin nga përrroi i egërsuar. Sytë e tij të murrmë u bënë më të rreptë. Sa herë e kish

kaluar atë edhe kur koha kish qenë kallkan. Atë çast ai ish bërë i rrëmbyer dhe i prishte punë. S'mund ta kapërcente dot me bagëtinë.

... Befas Balua zgjati veshët, tundi bishtin dhe zuri të angullijë si në të qarë. Pastaj s'u përbajt më, u hodh andej nga dukej një hije dhe zuri të kacafytej.

Dhentë u strukën kokë më kokë.

«Ujku — tha Lipja me vete dhe u vërsul andej nga qeni. — Do të hyjë në bagëti, i flamosuri. Por jo, more jo, nuk të lë Lipja ty të bësh si të duash».

Balua i kish ngulur egërsirës dhëmbët në zverk dhe s'e lëshonte. Ujku turfullonte si i tërbuar dhe mundohej të shkëputej.

Lipja vetëtimthi hodhi gunën mbi bishën dhe i ra përsipër, pastaj me një të lëvizur nxori thikën dhe e nguli dy a tri herë mbi gunë.

U ndje një uluritje e tmerrshme dhe ujku ra shakull mbi baltë.

— Ma more të keqen! — thirri Lipja. — Pa le, pa le, kjo bagëti do shkojë në male e ti doje ta shqyeje. S'turpërohet Lipja kollaj, është kockë e fortë.

Si i ra edhe një herë me një gur kokës, e zuri nga këmba dhe e tërhoqi zvarrë.

Shiu vazhdonte të binte dhe i kullonte bariut curkë mbi qafë e në gjithë trupin. «Pa çka, sa të shkoj në shtëpi, do ndërrohem» — i jepte ai durim vetes.

Pastaj, duke kthyer kokën nga ujku që hiqte zvarrë, mendoi: «Kot s'thonë se ujku ka lindur pér tē bërë plaçkë, por dhe pér tē rënë pre.»

Tundi kokën dhe qeshi. Balua që qëndronte aty pranë, tundte bishtin dhe lëpinte gjuhën. Lipja e përkëdheli. Pastaj ju afrua deleve, u dha zemër dhe i ngau përparrë. Ua kish mësuar gjuhën atyre. S'kish frikë t'i iknin më. Duhet tē gjente urën...

Papritur jo dhe aqë pranë, bariu pa tē vezullo-nin ca drita. Pastaj dëgjoi tē lehura qensh dhe zë-ra njerzish. Lipja ua vuri veshin këtyre zhurmave që sa vinte e afroheshin.

Gishtrinjtë e tij tē ashpér që têrhiqnin têrku-zën me tē cilën kish lidhur ujkun, filluan tē gjallë-roheshin. Ndjeu krahrorin t'i lehtësohej. «Të jenë shokët vallë.» Fytyra filloj t'i shkëlqejë kur barinjtë e tjerë u afruan me fener në duar.

«Po, ata janë, shokët!» — tha me vete. Në ato çaste ziente nga dëshira pér t'i përqafuar. I njihet Lipja ata. Ishin njerëz tē thjeshtë si ai, me zemër tē hapur.

— O Lipe! O Lipe! Po ç'u bëre, more djalë? Nga humbe? — tha xha Trifoni, bariu më i vjetër, dhe ngriti fenerin pér tē parë më mirë bariun e ri. Po atë çfarë e ke more, dele? Babaxhan, qenka ujk! Siç duket ke hequr keq, xhan i vëllait. Por paske fituar. Të lumtë! Të njoh unë ty, s'na e turpëron ti kooperativën!

Pastaj ju drejtua të tjerëve: — A nuk ju thashë? S'jepet kollaj Lipja. Merrjani ujkun se është lodhur.

— Jo, or xha Trifon, s'ndjej më lodhje unë — ja priti Lipja duke buzëqeshur. Dhe me të vërtetë ashtu ishte. Bariu i ri ishte gjallëruar në fytyrë dhe e kish harruar lodhjen kur kishte parë shokët.

— Hajdeni, djema! Ngajeni bagëtinë drejt urës! Ta marrë vesh gjithë fshati se me Lipen gjithmonë do dalim faqebardhë. E meriton një fletë-rrufe dhe të madhe bile — foli një tjetër.

Barinjtë qeshën. Pastaj xha Trifoni ju afrua Lipes dhe i shkoi dorën në qafë.

Bagëtia u nis drejt urës.

Qentë vazhdonin të lehnin, sikur donin të jepnin lajmin e gëzuar. Udha ndriçohej nga fenerët. Pas pak u dukën dhe dritat e fshatit.

ALFRED PAPUCIU

## LËNDA

Faqe

Partisë	<i>Gj. Junçaj</i>	3
Partia	<i>H. Buçpapa</i>	4
Partisë sime	<i>B. Nurçe</i>	5
Poezi mbi poezi	<i>A. Nuri</i>	7
Flamujt valviten	<i>D. Bekteshi</i>	8
Vendlindjes së kaltër	<i>M. Zeqo</i>	13
Dejeve të tua, Atdhe	<i>B. Londo</i>	16
Moli i Durrësit	<i>Sh. Karadaku</i>	18
Ditët me diell	<i>N. Kacalidha</i>	20
Hidrocentrali i Vaut të Dejës	<i>Sh. Karadaku</i>	22
Malësisë së Madhe	<i>M. Xhaferaj</i>	23
Pranverë	<i>B. Londo</i>	25
Kënga e elektriçistëve	<i>Ll Nano</i>	69
Nëndor	<i>Zh. Jorganxhi</i>	27
Zogu i stuhive	<i>M. Zeqo</i>	28
I plagosuri	<i>A. Nuri</i>	31
Ne erdhëm pas teje	<i>K. Odriçani</i>	24
Përroi i egër, i bukur, i lashtë	<i>M. Lino</i>	34
Kthimi i Skënderbeut	<i>R. Lasku</i>	35
Uniforma e blertë	<i>N. Kacalidha</i>	36
Përshëndetje bashkëfshatarëve të mi	<i>N. Kacalidha</i>	38
Shtëpisë shkodrane	<i>S. Terpo</i>	41
Mësuesi ynë		40
Marhon gjithmonë me ne	<i>V. Llakaj</i>	43
Aksionistja e përjetëshme	<i>M. Zeqo</i>	46
Kujtim për Shkurten	<i>Sh. Alltari</i>	

49T53

## BIBLIOTEKA E SHTRIJËV

Faqe

Ajo dhe kënga	V. Gaba	47		
Trompetë e alarmit	në rëntë	M. Lino	32	
Dje dhe sot	A. Rustaj	49		
Ti...	Zh. Jorganxhi	50		
Mira	E. Peposhi	51		
Për Gitën	D. Popaj	53		
Mirupafshim,	Nanë	M. Elezi	55	
Një ditë	në trase	58		
Sonte	në sektor	M. Elezi	59	
Ti u ngjite	M. Elezi	61		
Kurrë s'të	ndava nga	këto vise	B. Londo	63
Dielli im	S. Terpo	64		
Vargjet	e mia	M. Çela	65	
Vargje	në mëngjez	V. Musta	66	
Studenti	në fshat	Ll. Nano	68	
Ne,	pasardhësit	Ll. Nano	70	
Në	kishë	R. Lasku	70	
Mësues	B. Tahiri	71		
Mësuesit	D. Popaj	73		
Sportisja	e re e lagjes	A. Nuri	74	
Letër	nga aksioni	V. Musta	75	
Mëngjezi	i parë i punës	Sh. Karadaku	77	
Nata	e fundit	e aksionit	Sh. Karadaku	79
Roje	nate	R. Lasku	80	
Detarët	M. Zego	81		
Qyteti	im	V. Gaba	83	
Bisedë	me Majakovskin	N. Kacalidha	84	
Stuhi	drite	F. Malo	94	
Ne	jemi bashkë, baba!	Sh. Tigani	110	
Hapat	në rrugën	e kaldrëmtë	Sh. Tigani	120
Buzëqeshje	A. Papuçiu	127		
Bariu	A. Papuçiu	135		